

# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3257 · e premte 29 dhjetor 2017

2°C | 8°C

15 DEN



**38 vjetori i gabimit në Afganistan**

Fq.12-13

## AKTUALE

**Dhjetë vjet ITSHKSH në një monografi**



Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore ka botuar një monografi me rastin e dhjetë vjetorit të themelimit. Bëhet fjalë për një publikim që përfshin punën e këtij institucioni që nga themelimi, botimet, konferencat dhe aktivitetet e zhvilluara, drejtuesit dhe punonjësit shkencorë që kanë kontribuar gjatë këtyre viteve, vlerësimet e dhëna, e të tjera. Sa i takon arritjeve gjatë një dekade....

Fq.9

## DOSSIER

**Qeveria e RSM-së pas publikimit të Deklaratës politike të PDP-së**

Fq.18

## GLOBI

**Ekonomia gjermane optimiste për vitin 2018**

Fq.15



## DEPUTETËT E ASH-së LISTOHEN SI DEPUTETË OPOZITAR

# LIGJI PËR GJUHËT VOTOHET MË 9 JANAR



**“Nëse presidenti nuk e nënshkruan Ligjin në fjalë apo çfarëdo Ligji tjetër, atëherë e njëjta kthehet në Parlament dhe në afat prej 30 ditëve duhet të shqyrtohet dhe të votohet. Nëse votohet sërish i njëjti Ligj, atëherë me automatizëm hyn në fuqi edhe pa nënshkrimin e presidentit”, theksoi kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi**

Fq.3

## Bizneset, secili kërkon ilaç për hallet e veta

**Shkup, 28 dhjetor** - Një pjesë e afaristëve mirëpresin masat e reja qeveritare për rritjen ekonomike, barazimin e kushteve për investime për biznesin vendor dhe të jashtëm, përkrahjen e eksportit dhe mbështetjen më të madhe për kompanitë e vogla dhe të mesme, por megjithatë shtojnë se ato janë shumë të përgjithësuara dhe jo shumë konkrete. Sipas Menderez Kuçit, anëtar i Këshillit Drejtues të

Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore, mungon një strategji operative për realizimin e planit ekonomik qeveritar, për të cilin nuk e ka fajin vetëm ekzekutivi, por edhe të gjitha Odat Ekonomike për shkak se aktualisht - pjesa më e madhe e sektorëve në mënyrë individuale kërkon ilaç për problemet e veta duke filluar nga tekstili, turizmi apo komunikacioni. “Nuk mundet që çdo...

Fq.6



## LAJMI I FUNDIT

## NATO E RËNDËSISHME PËR EKONOMINË DHE QYTETARËT

Ekzistojnë shumë arsye pse Maqedonia me pothuajse 75,80 për qind të qytetarëve të përcaktuar është për NATO dhe BE dhe me këtë edhe kjo Qeveri dhe të gjithë subjektet politike në shtet janë në atë drejtim, tha kryeministri Zoran Zaev. Ai theksoi se një prej arsyeve kryesore është ekonomia dhe përfitimet ekonomike për qytetarët. "NATO po, do të thotë siguri dhe stabilitet, NATO para së gjithash do të thotë rritje ekonomike, investime ekonomike, vende të punës, paga më të mëdha dhe perspektiva para së gjithash ekonomike", theksoi Zaev.

Si për shembull nga fqinjësia më e afërt e theksoi Bullgarinë, kur sipas parametrave të cilat i kemi studiuar deri te anëtarësimi i saj në NATO ka investime të huaja në mesatare prej rreth 450 milionë euro, Në kontekst të kësaj, shtoi se kur bëhet vend anëtar i NATO-s investimet rriten më shumë se gjashtë miliardë. Në Shqipëri megjithatë, siç theksoi, investimet janë pesë herë më të larta në vitin e ardhshëm pasi ajo u bë anëtare e NATO-s. "Për momentin jemi miq, miq jemi me të gjithë, ai është vend i vogël, perspektivat e veta nuk mund t'i shikojë vetëm në tregun tonë. Prandaj është i rëndësishëm eksporti", nënvizoi kryeministri. Ne, siç tha, përmes atmosferës miqësore do të promovojmë kushte të cilat janë inkurajuese. Sipas Zaevit duhet të ekzistojë atmosferë e miqësisë dhe kjo mund të plotësohet vetëm me anëtarësim në NATO dhe BE.

## KAMENOS KUNDËR EMRIT QË DO TË PËRMBAJË FJALËN "MAQEDONI"

Ministri grek i Mbrojtjes, Panos Kamenos, i cili është lider i ANEL, partnerit kryesor të koalicionit në qeverinë e Aleksis Ciprasit, sot e përsëriti qëndrimin e tij se i kundërshtohet zgjidhjes së kontestit për emrin që do ta përmbajë fjalën Maqedoni dhe nuk do të përkrahë zgjidhje të tillë eventuale në parlamentin grek. "Pozita jonë mbetet që të jemi kundër përdorimit të shprehjes 'Maqedoni', deklaroi Kamenos. Ai i bëri thirrje Prokopis Pavlopulosit që të mbledhë të gjithë liderët e partive politike që të diskutojnë për kontestin për emrin me Maqedoninë", njoftoi Katimerini. Në konferencën e sotme për shtyp, Kamenos shtoi se qëndrimi i tij nuk duhet të kuptohet si kritikë e ministrit të punëve të jashtme Nikos Koxijas, për të cilin Kamenos tha se "është ministri më i mirë i punëve të jashtme që Greqia e ka pasur". Partia nacionaliste ANEL ka nëntë deputetë në Parlamentin grek, dhe me ndihmën e saj qeveria e Ciprasit ka shumicë prej 153 deputetëve në Parlamentin me gjithsej 300 anëtarë. Kirijakos Micotakis, lider i Demokracisë së Re, paradokohe i bëri thirrje Ciprasit dhe Kamenosit të japin dorëheqje për shkak se në qeveri nuk kanë qëndrim unik në kontestin me emrin.

### KUR INVESTIMI (NUK)KTHEHET NË EKONOMI

"Nuk e di çfarë ka ndodhe me autostradën Prishtinë-Gjilan. Por u tmerrova kur nga zyrtarë të Ministrisë së Transportit dëgjova edhe për një autostradë tjetër të Dukagjinit që buxhetit të Kosovës do t'i kushtojë rreth një miliard e gjysmë euro. Personalisht s'di që ka pas ndonjë studim paraprak për impaktin ekonomik të autostradave që janë shtruar, ose që janë duke u shtruar. Por, para se t'i hyjmë aventurave të reja miliarda euroshe asfalt, t'paktën kish bo me iu bo një analizë edhe autostradave ekzistuese se sa është kthyer ky investim miliarda euroshe në rritje ekonomike. Me shëndetësinë dhe arsimin që kemi, ndërtimi i autostradave është krim, sidomos nëse të paktën investimi nuk kthehet në zhvillim ekonomik", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga Kosova, Adrian Gola.

### GJURIQI, HASHIMI DHE OKB

"Gjuriqi thotë se 58 për qind e tokës në Kosovë i takon serbëve. Tregojini Hashimit me çka me u marrë e mos të merret me qëndrimin e OKB-së, sepse atje s'ka karrige për të ende", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti humanitar Sead Ramadani.

### ILIR META DHE JANULLATOSI SHQIPTAR

"Vetëm një president që nuk e do vendin e tij dhe shkel mbi krimet e shëmtuara që ka bërë kisha greke kundrejt figurave të ndritura të kishës ortodokse shqiptare, dhe kundrejt ortodoksëve të mëdhenj që luftuan për afirmimin historik dymijë vjeçar të kombit shqiptar - vetëm një i tillë, i jep shtetësinë shqiptare një peshkopi grek që prej 25 vjetësh nuk ka pranuar ta japë meshën në gjuhën shqipe. Jo vetëm kaq. Janullatosi është autori i denigrimit të figurës së peshkopit Fan Stilian Noli; autorit direkt të autoqefalisë së kishës ortodokse shqiptare dhe figurës së madhe të formimit intelektual të botëkuptimit real shqiptar. Nëse Ilir Meta ndihet i kërcënuar nga Reforma në Drejtësi, hapi i hedhur është i kotë, por kuptohet që ai po kërkon ndihmë sa nga Gruevski në Shkup, aq dhe në qarqet reaksionare greke në Athinë. Mund të vejë edhe në Beograd", shkruan deputeti shqiptar, Spartak Ngjela.

### S'JAM SI PARAARDHËSIT

"Luje mace krytë e bullit. 'Ia kam rritë rrogën vetes, se s'mund të dalë dosido, kuptoni, më duhet një kravatë, një këmishë, s'jam unë si paraardhësit e mi, si Isa Mustafa e këta cullakat tjerë me dalë shokë e nalt deshë, pa këmishë e pa kravatë. Tësia kopilesa, e dini ju. Me dasht e ly edhe by\*\*ën me kos, s'ma ninë mu, jam i gatshëm për vendime të mëdha. P.S. Sokrati gjatë gjithë jetës së tij e ka pasur dhe e ka veshur vetëm një mantel, lajë, bajë. 'Budallë' bre", shkruan në profilin e saj në FB, publicistja Kimete Berisha.

### MEDIACitate

Në rajonin e luftimeve në Ukrainën Lindore u krye shkëmbimi më i madh i të burgosurve që prej fillimit të konfliktit në vitin 2014. Udhëheqja e Kievit dhe separatistët proruse shkëmbyen qindra të burgosur. Pala ukrainase u dorëzoi separatistëve 237 të burgosur. Të ashtuquajturat Republika Donjeck dhe Luhansk lejuan kthimin e 73 të burgosurve. Sipas Presidentit të Ukrainës Poroshenko, ata ndërkohe kanë mbërritur në atdhe. Shkëmbimi i të burgosurve u parapri nga negociata që zgjatën me muaj, në të cilat morën pjesë përfaqësues të Ukrainës, të Rusisë, të Kishës Ortodokse ruse dhe të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

(DW, 28 dhjetor)

Prokurorët e gjyqtarët kosovarë bëhen me pagat më të mira në rajon. Kështu ka thënë ministri i Drejtësisë Abelard Tahiri, duke konfirmuar se vendimi i qeverisë për rritjen e pagave prek edhe sektorin e drejtësisë. Tahiri ka thënë se pret që kjo të sjellë edhe rezultate konkrete në punën e tyre, sidomos në luftën kundër korrupsionit. Ai në konferencën e fundit bashkë me kryesuesit e KGJK-së e KPK-së, ka folur edhe për pakon e ligjeve që prekin punën e gjyqësorit e të prokurorisë, që pritet të dërgohen së shpejti në Qeveri.

(Zëri, 28 dhjetor)

Ministria e Familjes dhe Politikës Sociale e Republikës së Turqisë që nga tetori i këtij viti ka siguruar rreth 6.5 milionë dollarë të ndihmës financiare për 136 mijë fëmijë të huaj. Ministria ka ofruar ndihmë financiare që nga fillimi i viteve 2000, në kuadër të programit të "Transferimit kombëtar të parave për programin arsimor". Programi në fjalë po zbatohet për të huajt, si dhe me mbështetje të Bashkimit Evropian (BE), UNICEF-it, Gjysmëhënës së Kuqe të Turqisë, Ministrisë Kombëtare të Arsimit dhe Ministrisë së Familjes, zbatimi i të cilës filloi në maj të vitit 2017 dhe që do të vazhdojë ndihmën financiare edhe në vitin e ardhshëm.

(Anadolu Agency, 28 dhjetor)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## A KA PATUR REALISHT PELLAZGË?

Pellazgët mendohet se janë një popullsi e lashtë mesdhetare parailire dhe paragreke. Përcaktimi i karakterit etnik të kësaj zone u shtrua si çështje që në lashtësi, si psh nga Straboni në shek.I para Krishtit. Në shekullin XIX dhe në shekullin XX çështjen e kanë rrahur gjuhëtarë, historianë e arkeologë që

japin zgjidhje të ndryshme. Gjatë Rilindjes Kombëtare pikëpamja se nga pellazgët e ka prejardhjen populli shqiptar u përkrah si mbështetje për të treguar lashtësinë e tij. Pikëpamjet e sotme më të rëndësishme përmblidhen në dy qëndrime kryesore: 1. Në Ballkan dhe në Mesdhe ka jetuar një popullsi e

tejlashtë me emrin Pellazgë që shërbeu si bazë për formimin e popullive të ndryshme të mëvonshme të kësaj treve; 2. Në kohën e tejlashtë në Ballkan dhe në Mesdhe nuk ka pasur as popullsi të njëjtë dhe as emër të njëjtë për të gjitha këto treva; prandaj emërtimi Pellazgë është i pasaktë. Në këtë rast popullsitë quhen para-ilire, para-greke dhe para-trake, pra përjashtohet mundësia e përcaktimit të karakterit të tyre etnik.



DEPUTETËT E ASH-së LISTOHEN SI DEPUTETË OPOZITAR

# LIGJI PËR GJUHËT VOTOHET MË 9 JANAR

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 28 dhjetor - Ligji për përdorimin e gjuhës do të jetë në seancë plenare për votim më 9 janar, por hyrja në fuqi e këtij Ligji mund të vonohet për të paktën 30 ditë në rast të mos nënshkrimit të presidentit Ivanov. Kështu ka thënë kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, gjatë takimit të fundvitit me gazetarë, ndërsa është shprehur se në 2018, nuk e besoj të ketë zgjedhje të parakohshme. "Nëse presidenti nuk e nënshkruan Ligjin në fjalë apo çfarëdo Ligji tjetër, atëherë e njëjta kthehet në Parlament dhe në afat prej 30 ditëve duhet të shqyrtohet dhe të votohet. Nëse votohet sërish i njëjti Ligj, atëherë me automatizëm hyn në fuqi edhe pa nënshkrimin e presidentit", theksoi Xhaferi. Ai shtoi se për vitin 2018-të Maqedonisë nuk i nevojiten zgjedhje të parakohshme, pasi siç tha ai, pikërisht vitin e ardhshëm pret që të jetë i qetë në aspektin të funksionimit të Parlamentit, ndërsa për vitin që po lëmë pas - Xhaferi e vlerësoi si të suksesshëm me theks tek formimi i Qeverisë së re reformatore.

"Pritshmëritë për vitin 2018 në kontekst të asaj çka është jeta politike në Parlament dhe në Republikën e Maqedonisë, mendoj që të ketë një stabilitet më të qëndrueshëm për faktin që gjithë mosmarrëveshjet brendapartiake që kanë qenë në fundvit, mendoj se do të jenë të tejkalueshme në kuptimin e organizimit të subjekteve politike dhe ata të vazhdojnë të jenë pjesëmarrës në punimet e rrugullta të Parlamentit nga fillimi i punimeve pas festave, gjegjësisht nga 9 janari. Besoj se viti 2018 do të jetë një vit më i qetë politik në fushën e asaj çka është debati parlamentar, për faktin që edhe deklaratimet e subjekteve politike parapakisht se janë të gatshëm të mbështesin projektet reformuese kundrejt pritshmërive të raport-progresit të Komisionit Evropian dhe pritshmërive rreth anëtarësimin në NATO. Dhe kjo është çështje që subjektet politike janë deklaruar se do të jenë koshient për pjesëmarrje dhe kyçjen e tyre në proceset e punimeve të Parlamentit", deklaroi kryeparlamentari Xhaferi. Por sa i përket kthimit në Parlament të deputetëve të opozitës, koordinatori joformal i grupit parlamentar të VMRO-se, Vlatko Gjoçev tha se edhe më tej nuk do të marrin pjesë në punimet e Parlamentit. Ai shtoi se janë të revoltuar nga vendimi i gjykatës që të enjten ua ka vazhduar paraburgimin deputetëve të akuzuar për ngjarjet e 27 prillit në Parlament.



ZORAN ZAEV

**Aleanca për Shqiptarët do të mbështes reformat dhe gjithçka që është në interes të qytetarëve dhe integritet në BE dhe NATO. Dua bashkëpunim edhe me BESËN, edhe me VMRO-në dhe me partnerët e tyre të koalicionit, pasi jam i bindur se Maqedonia ka një shans që nuk duhet ta lëshojmë. Gjysma e parë e vitit 2018 është mundësi e mirë që pas 12 vitesh status të kandidatit të marrim datë për fillimin e bisedimeve**

"Kjo është situatë e re, vazhdimi i paraburgimit për 29 të akuzuarit... Për Krishtlindje dhe Vitin e Ri është njerëzore që ata të jenë në shtëpi, jo në paraburgim. Për bashkëpunim duhet dy palë, kryetari i VMRO-së Mickovski zgjati dorën", tha Gjoçev. Ndryshe, kryeparlamentari Xhaferi gjatë brifingut me gazetarë në lidhje me harxhimet e deputetëve, tha se po shqyrton variantin që atyre që udhëtojnë më shumë se 50 kilometra, t'u jepet banesa zyrtare ose t'u paguhet qiraja e banesës. "Sa i përket harxhimeve rrugore, nga Instituti e kam marrë raportin, do t'i shoh llogaritë. Një ndër variantet është që deputetët që vijnë nga jashtë Shkupit, gjegjësisht udhëtojnë më shumë se 50 kilometra, të marrin banesë zyrtare ose t'u paguhet qiraja", tha Xhaferi. Ai tregoi se në Buxhetin e Parlamentit

për vitin e ardhshëm është paraparë blerja e katër veturave të reja, me arsyetimin se dy veturat aktuale nuk mjaftojnë për shërbimet e Parlamentit. "Veturat përdoren edhe për Qeverinë dhe për këtë shkak, do të furnizohen me të reja për nevojat e Parlamentit. Një 'Golf z' dhe 'Pikap', këto janë dy veturat e vetme në Parlament. Nëse mendoni se i ngjajnë Parlamentit, atëherë fotografojeni", theksoi Xhaferi.

Ndryshe, të enjten në Parlament ishte dhe seanca e dytë dhe e fundit për këtë e pyetjeve të deputetëve, me ç'rast deputeti nga Lëvizja BESA për herë të parë për opinion foli për, siç tha Rexhep Memedi, një skandal me hedhjen e mbeturinave përmes 140 kontejnerëve nga Italia në deponinë Drislla, 500 metra afër fshatit Batincë të Komunës së Studeniçanit.

"A është në dijeni ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për skandalin me hedhje së plehrave nga Italia në deponinë Drislla - edhe atë vetëm 50 metra nga fshati Batincë i Komunës së Studeniçanit. Kemi informata se në vitin 2012, rreth 25 ton plehra nga Italia janë sjellë përmes 1140 kontejnerëve dhe janë zbrazur në deponinë Drislla", ishte pyetja e deputetit Memedi nga Lëvizja BESA drejtuar ministrit të Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Sadulla Durakut, i cili nuk ishte prezent në sallë dhe mbeti që përgjigje ti jepet me shkrim deputetit në fjalë. Nga deputetët e Aleancës për Shqiptarët, të cilët u listuan si deputetë të opozitës në Parlament, Syrija Rashidi pyeti kryeministrin Zaev nëse ka ndryshuar ai apo ka ndryshuar BDI kur bëhet fjalë për identifikimin të korrupuarëve nga ish-qeveria VMRO-BDI dhe premtimet e Zavrit gjatë fushatës parazgjedhore se Ligji do të vlejë për të gjithë ai të jetë në pushtet. "Edhe atëherë e kam theksuar dhe tani e përsëris: Ligji do të vlejë për të gjithë, edhe kur bëhet fjalë për LSDM-në, BDI-në, Aleancën, Lëvizjen BESA. Deri më tani kam informata se me dhjetëra raste

"Nëse presidenti nuk e nënshkruan Ligjin në fjalë apo çfarëdo Ligji tjetër, atëherë e njëjta kthehet në Parlament dhe në afat prej 30 ditëve duhet të shqyrtohet dhe të votohet. Nëse votohet sërish i njëjti Ligj, atëherë me automatizëm hyn në fuqi edhe pa nënshkrimin e presidentit", theksoi Xhaferi

nga ministrinë janë kallëzuar deri tek Prokuroria Publike, e cila do të fillojë proces gjyqësor nëse gjen se ka arsye. Të mos tentojë dikush të ndikojë në institucionet. As që kam menduar edhe as marrë ndonjë informacion për urgjencë në institucionet e drejtësisë. Pa dallim se cilës parti i takon, i korrupuari do të përballë me ligjin", theksoi kryeministri Zoran Zaev. Në pyetjen tjetër të deputetit Rashidi nëse ka pasur formatim apo plotësim të Qeverisë, Zaevi nuk la pa e përsëritur faktin se Ministria e Shëndetësisë i ka takuar ASH-së për shkak të, siç tha ai, pritshmërive të mjekëve që të zgjidhet Arben Taravari. "Dëgjova nga mediat se Taravari do kandidohet për Gostivarin. Në atë moment u luta që Taravari të mos fitojë që të mbetet ministër. Asnjëherë nuk do i mbyll dyert për ASH për bashkëpunim. Unë dua bashkëpunim për gjithë opozitën", tha Zaev. Kryeministri Zoran Zaev në kuadër të seancës për parashtrimin e pyetjeve të deputetëve ka paralajmëruar se mbetet mundësia për bashkëpunim me gjitha partitë dhe ata që ishin deri tani pjesë e shumicës qeveritare, por edhe me partitë e opozitës. "Aleanca për Shqiptarët do të mbështes reformat dhe gjithçka që është në interes të qytetarëve dhe integritet në BE dhe NATO. Dua bashkëpunim edhe me BESËN, edhe me VMRO-në dhe me partnerët e tyre të koalicionit, pasi jam i bindur se Maqedonia ka një shans që nuk duhet ta lëshojmë. Gjysma e parë e vitit 2018 është mundësi e mirë që pas 12 vitesh status të kandidatit të marrim datë për fillimin e bisedimeve", ka thënë Zaevi.

## POZICION UNANIM PËR EMRIN E MAQEDONISË

**Partia kryesore opozitare greke, Demokracia e Re, i bëri thirrje Qeverisë që të dalë me propozim unanim për emrin me Maqedoninë, për shkak të, siç tha, dallimeve të parashtruara në radhët e saj për këtë çështje, njoftoi gazeta "Katimerini". Konservativët grekë, në qëndrimin e publikuar në Katimerini, kategorikisht e hedhin poshtë idenë të hedhur nga shefi i diplomacisë Nikos Koxijas se zgjidhja me kontestin me Shkupin mund të gjendet në Parlament vetëm me shumicën e deputetëve të të dy partive, që janë të përfaqësuar në Qeveri. Pas kësaj ideje ata druan nga tentativa e partive politike që t'i**

**fshihin mospajtimet dhe dallimet që janë të paraqitura në radhët e tyre. Pasi që lideri i partnerit më të vogël të koalicionit dhe ministri aktual i Mbrojtjes, Panois Kamenos, njoftoi se nuk do të përkrahë zgjidhje të kontestit me Shkupin për emrin në të cilin do të figurojë fjala Maqedoni. Edhe Siriza gjithashtu në radhët e saj ka deputetë që nuk janë në disponim, madje edhe janë kundër pranimit të emrit me përcaktim gjeografik. Edhe partia opozitare Potami, gjithashtu i bëri thirrje Qeverisë që ta ashpërsojë pozicionin e saj lidhur me kontestin për emrin.**

ZGJIDHEN MË TË MIRËT E "HISTORIANËVE TË RINJ" NË ZLM

# HISTORIA E KOKLAVITUR



Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 28 dhjetor - Gjetja e pikëtaki-  
meve mes historisë dhe teknologji-  
së informatike, duke qëndruar në  
mes urë lidhëse mes të kaluarës  
dhe të ardhmes, ishin sfida që të  
enjtën u përmbyll me sukses nga  
gjimnazistët e "Zef Lush Markut"  
në Shkup. Për rreth katër muaj, pro-  
fesorët e kësaj lënde u angazhuan  
dhe punuan me nxënësit e viteve të  
para për projektin "Mësimdhënia  
e historisë dhe teknologjia infor-  
matike" duke i motivuar në puni-  
min e temave që kanë të bëjnë me  
gjenezën e historisë njerëzore, fi-  
set ilire dhe Maqedoninë antike.  
Mirëpo, çështja e mësimdhënies  
në këtë lëndë është shumë më e  
ndëllikuar nga sa mund të pritët,  
pasi ka shumë gjëra të cilat në vend  
që të mirëkuptohen - keqkuptohen  
dhe keqinterpretohen. Sakaq, në  
shkollat e Maqedonisë, ku sot e kësaj  
dite janë për përdorim zyrtar li-

bra që ofendojnë shqiptarët, më-  
simdhënia në lëndën e historisë  
komplikohet dhe vështirësohet  
ende më shumë.

Profesor Naser Miftari, i cili  
drejtoi projektin "Mësimdhënia e  
historisë dhe teknologjia infor-  
matike", tregon për sfidën që duhej  
tejkualuar. "Mësimdhënia është një-  
ra prej veprimtarive më të shenjta,  
mirëpo kur hyn në mes historia-  
bëhet njëra prej veprimtarive mba-  
se më të komplikuar. Për ti për-  
balluar të gjitha sfidat dhe për të  
mbajtur lidhjen mes të vjetrës dhe  
të resë, na është dashur të jemi jo  
vetëm të kujdesshëm, por bashkë-  
veprues edhe me prindërit për t'i  
motivuar nxënësit që të gjejnë më  
të mirën e mësimdhënies në këtë  
lëndë", tregon Miftari. Historia, si-  
pas tij, u keqpërdor çdo herë prej  
atyre që në ADN-në e vet kanë qël-  
lime egoiste e personale dhe që  
shkencën e shndërruan në mjet për  
shpërndarjen e keqkuptimeve dhe

keqinterpretimeve. Prandaj, plotë-  
son më tej profesor Miftari, në më-  
simdhëniesit e historisë ballafa-  
qohemi me probleme të natyrave  
të ndryshme, objektive dhe subjek-  
tive, ndërsa thotë se kanë bërë  
maksimumin që të motovojnë  
nxënësit në mësimin sa më objek-  
tiv të lëndës, si dhe dhënien e më-  
simin të kësaj lënde me metoda sa  
më atraktive, të mundësuar ato  
nga shkenca e teknologjisë infor-  
matike. "Historia, nga retrospektiva  
në perspektivë është sfida e histo-  
rianëve të rinj, të cilët nuk janë  
aspak fajtorë për vështirësitë dhe  
barrierat që hasen gjatë mësimin,  
studimit dhe ligjërimit të kësaj lën-  
de", vëren më tej ai. Për realizimin e  
këtij projekti, profesor Miftari  
krahas kolegëve të lëndës - ka pasur  
mbështetjen e edhe të kolegëve  
tjerë, sidomos të artit figurativ,  
informatikës, gjuhës shqipe, psiko-  
loges dhe drejtorit të shkollës. Li-  
brat aspak cilësore të historisë, janë

një sfidë më vete. "Natyrshisht që për  
punimin e temave, mentori i  
nxënësve profesor Naser Miftari u  
ka dhënë atyre mundësi që të sh-  
frytëzojnë apo të konsultohen  
edhe literaturë jashtë njësive mësi-  
more, posaçërisht për kohën e pe-  
riudhës ilire", thotë profesori tjetër  
i historisë, Besnik Rahmeti. Në  
shkollë, plotëson më tej ai, jemi të  
detyruar të punojmë me librat të ci-  
lat janë lëshuar në përdorim nga  
Ministria. "Mirëpo, në rastin e këtij  
projekti, kur nxënësit zgjidhnin të  
thellojnë njohuritë e veta për tema  
të caktuara mentori i tyre, profesor  
Miftari u ka ofruar edhe materiale  
të tjera, libra më të thelluar në  
shkencën e historisë". Profesor Ra-  
meti, tregon se në librat zyrtar, pra  
në ato që profesorët janë të dety-  
ruar ti shfrytëzojnë si mjet punë  
gjatë zhvillimit të orëve të rëndom-  
ta të historisë ka ende pjesë konte-  
stuese. "Kontestet historikë vërehen  
posaçërisht te fiset ilire. Konkreti-

"Mësimdhënia është njëra prej  
veprimtarive më të shenjta,  
mirëpo kur hyn në mes historia-  
bëhet njëra prej veprimtarive  
mbase më të komplikuar",  
pohon profesor Naser Miftari.  
Historia, sipas tij, u keqpërdor  
çdoherë prej atyre që në ADN-  
në e tyre kanë qëllime egoiste e  
personale dhe që shkencën e  
shndërruan në mjet për  
shpërndarjen e keqkuptimeve  
dhe keqinterpretimeve

sht Dasaretët i gjejmë të numëruar  
edhe si fis i ilirëve edhe si fis i maqedo-  
nasve. Pra, krijohet një konfu-  
zion pasi në tekstet shkollore të hi-  
storisë nuk nënvizohet fakti se  
maqedonasit janë fis ilir. Prandaj,  
duhet të jemi të kujdesshëm neve  
historianët, pra profesorët e histo-  
risë që t'jua shpjegojmë nxënësve  
këtë fakt", sqaron profesor Rahme-  
ti. Projekti "Mësimdhënia e historisë  
dhe teknologjia informatike" u  
përmbyll me ndarjen e tre çmimeve  
të para të cilat u takuan nxënësve  
Adis Ramadanit, Egzona Bek-  
teshit dhe Arita Vranecit, si dhe me  
një program kulturor ku u shpalo-  
sën vlerat e veshjeve popullore,  
ushqimeve tradicionale, dhomave  
dhe muzikës së rapsodëve. U ndanë  
githashtu mirënjohje për shtëpinë  
botuese "Shkupi", e cila ndau libra  
për 30 nxënësit pjesëmarrës në  
këtë projekt, si dhe për Shoqërinë  
Kulturore-Artistike të Rashçes.

Deputeti Ferid Muhiq  
e theksoi nevojën për  
kthimin e aspektit  
human dhe të  
dënuarit me dënim të  
përjetshëm që të mos  
anashkalohe nga  
amnistia

Shkup, 28 dhjetor - Komisioni par-  
lamentar për sistem politik tw enj-  
ten mbajti debat publik për Pro-  
pozim-ligjin për amnisti në të cilin  
morën pjesë edhe ministri i  
Drejtësisë, Bilan Saliji, zëvendë-  
sministri i Drejtësisë, Oliver Ri-  
stovski, Avokati i Popullit, Ixhet  
Memeti, si dhe përfaqësues të sek-  
torit joqeveritar. Me Propozim-  
ligjin parashikohet lirim nga  
vuajtja e dënimit me burg të për-  
rafësisht 670 personave të dënuar  
me aktvendim të plotfuqishëm  
me burgim deri në gjashtë muaj,

DEBAT PUBLIK PËR PROPOZIM-LIGJIN PËR AMNISTI

## AMNISTIA, TË KTHEHET ASPEKTI HUMAN

ndërsa për 3.097 persona ulje të  
dënimit për 30 për qind. Gjatë  
dorëzimit të ligjit parasysh janë  
marrë kushtet në institucionet  
ndëshkuese-përmirësuese dhe të  
burgosurit. Avokati i Popullit thek-  
soi se ky ligj është i kombinuar,  
gjegjësisht sa është material, aq  
është edhe i procesuar. "Nuk  
mund të miratohet ligj për amni-  
sti pa usjellë edhe procedura se si  
duhet të zbatohet. Konsideroj se  
procedura për zbatim duhet të  
përkufizohet që të mos ketë dalli-  
me në zbatim dhe pabarazi", de-  
klaroi Memeti. Deputeti Ferid  
Muhiq e theksoi nevojën për kthi-  
min e aspektit human dhe të dë-  
nuarit me dënim të përjetshëm që  
të mos anashkalohe nga amni-  
stia. Aktivistja civile Meri Nikollo-

va pyeti se si mundet neni 125 t'i  
nënshtrohet amnistisë, ndërsa  
neni 123 jo dhe lexoi letër nga fa-  
miljet e të dënuarve në lëndën  
"Detonatori", në të cilën kërkohet  
që të mos ketë selektim dhe ata  
të përfshihen në amnisti. Goce Ko-

cevski nga Shoqata e juristëve të  
rinj theksoi se mungon individua-  
lizëm dhe vendoset barazim të ra-  
steve me peshë të pabarabartë si  
bashkimi kriminel dhe kundër-  
vajtjet e komunikacionit dhe  
vjedhjet. Deputeti Fadil Zendeli

tha se miratimi i ligjit nuk mund të  
arsyetohet me vërejtjen e stërn-  
garkimit të burgjeve, duke thek-  
suar se sigurimi i kushteve janë  
obligim i shtetit i cili duhet të pa-  
rashikojë më shumë mjete nga  
Buxheti për këtë. (O.Xh)

GJYKATA E APELIT E SHFUQIZOI VENDIMIN E SHKALLËS SË PARË PËR "RYSHFETIN"

Gjykata e Apelit Shkup, pas mbajtjes së  
seancës publike për lëndën e njohur në opinion  
si "Ryshfeti", solli vendim me të cilin e  
shfuqizoi vendimin e gjykatës së shkallës së  
parë dhe lëndën e ktheu në rigjykim në  
gjykatën e shkallës së parë. Siç kumtoi Gjykata  
e Apelit, gjatë procedurës dhe vendosjes për  
Propozimin e mbrojtjes për ndarjen e  
dëshmive të marra me masa të posaçme  
hetuese, të vendosura në seancën për debatin

kryesor, gjykata e shkallës së parë ka vepruar  
në kundërshtim me procedurën e paraparë  
ligjore kur me propozim të mbrojtjes për të  
cilën nuk ka ekzistuar pajtim nga palët, në  
vend të vendimit të silleit nga Këshilli  
që ka qenë në mbledhje, vendimin në mënyrë  
shtesë jashtë seancës për debatin kryesor e ka  
sjellë kryetari i këshillit me të cilin në rastin  
konkret ka dalë jashtë autorizimeve të  
konfirmuara me ligj.

## AVOKATI I POPULLIT KONSTATON PARREGULLSI NË PUNËN E POLICISË



# ARRESTIMI JASHTËLIGJSHËM I DEPUTETËVE

Vërtetimin se gjatë arrestimit të deputetëve të VMRO-së, ekziston shkelje ligjore, nga zyra e Ombudsmanit e kanë mbështetur në përmbajtjen e nenit 19 të Rregullores për punën e policisë, i cili thotë se "nëse personi që arrestohet thirret në statusin që i jep imuniteti, nëpunësi policor pas verifikimit të dokumenteve, me të cilat dëshmohet një status i tillë, duhet ta ndërpres procedurën e arrestimit dhe për këtë ta njoftojë eprorin e drejtpërdrejtë policor"

Koha

Omer XHAHERI

Shkup, 28 dhjetor - Arrestimi i tre deputetëve të VMRO-së: Kërste Mukovski, Zhaklina Peshevska dhe Luben Arnau-dov, mëngjesin e 28 nëntorit është realizuar në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Parlamentit. Në bazë të procedimit të parashtrësës, të cilën grupi parlamentar i deputetëve të VMRO-së e ka parashtruar deri te zyra e Avokatit të Popullit, thuhet se gjatë privimit nga liria i deputetëve në fjalë është cenuar e drejta e imuniteti të deputetëve. Paralelisht me këto veprime, shkelje tjetër të cilën e kanë kryer nëpunësit policor është mos respektimi i procedurës juridike, të përcaktuar me nenin 19 të Rregullores për mënyrën e veprimit të policisë. Vërtetimin se gjatë arrestimit të deputetëve të VMRO-së ekziston shkelje ligjore, nga zyra e Ombudsmanit e kanë mbështetur me përmbajtjen e nenit të apostrofuar, i cili thotë se: "nëse personi që arrestohet thirret në statusin i cili i jep imunitet, nëpunësi policor pas verifikimit të autencitetit të dokumenteve, me të cilat dëshmohet një status i tillë, duhet ta ndërpres procedurën e arrestimit dhe për këtë ta njoftojë eprorin e drejtpërdrejtë policor".

Konform kompetencave ligjore, Om-

budsmani Ixhet Memeti, në një takim me gazetarët të enjten njoftoi se nga drejtuesit e Ministrisë për Punë të Brendshme ka kërkuar sqarime, informacione dhe prova për veprimet policore të ndërmarra gjatë bastisjes, arrestimit dhe kontrollit të deputetëve të VMRO-së. Për dallim nga herët e kaluar, Ombudsmani nënvizoi se bashkëpunimi në relacion Avokati i Popullit-MPB, dukeshim është përmirësuar, me çka nga ky institucion i kanë dorëzuar rreth 38 dokumente (urdhëresa për kontroll, arrestim, procesverbale) të cilët lidhen me punën e policisë gjatë aksionit të realizuar me 28 nëntor të këtij viti. Megjithatë, pyetjet e parashtruar në detaje për këtë rast, nga kjo ministri nuk u janë përgjigjur. "Ne kemi konstatuar se me arrestimin e deputetëve, të cilët gëzojnë imunitet, është shkelur e drejta e imunitetit të deputetit, parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi policia nuk i ka respektuar një sërë normash ligjore. Deputet në këtë mënyrë, me pranga në duar janë shoqëruar deri në gjykatë, ku pas një qëndrimi disa orësh - janë liruar, ndërsa masa e paraburgimit u është shqiptuar disa ditë më vonë, respektivisht pasi që Parlamenti dha pëlqimin që këtyre deputetëve t'u hiqet imuniteti", tha Memeti. Duke i pasur parasysh këto zhvillime

dhe parregullsi, zyra e Avokatit të Popullit në Shkup deri te MPB ka dorëzuar një Rekomandim, në të cilin kërkohet zbatimi i procedurës së plotë për shqyrtim të mënyrës se si kanë vepruar nëpunësit policor dhe eprorët e tyre gjatë aksioneve me datë 28 nëntor të këtij viti. Më saktësisht, siç njoftoi Memeti, nga kryeshefi i policisë është kërkuar që të konstatojë përgjegjësi dhe shqiptojë sanksione disiplinore ndaj personave që i kanë shkelur të drejtat e deputetëve.

Ndryshe, nga Avokati i Popullit, kanë thënë se e respektojnë pavarësinë dhe autonominë e pushtetit gjyqësor, megjithatë ato e kanë parë të udhës dhe të parashtrorin pyetjen se pse nga ana e Gjykatës Penale të Shkupit është lëshuar urdhër për arrestim dhe kontroll të personave të cilët gëzojnë imunitet, pa u shfuqizuar (hequr) i njëjti, në përputhje me atë që është përcaktuar me aktet normative? Në vazhden e këtyre ngjarjeve, po ashtu nga zyra e Ombudsmanit apelojnë deri te Gjykata në fjalë, që gjatë miratimit të vendimeve gjyqësore, të respektojnë të drejtën e imunitetit, për shkak se kjo e drejtë nuk është hera e parë që me urdhër gjyqësor, Gjykata e shkel imunitetin si e drejtë e një kategorie të caktuar personash.

## Edhe një padi kundër Kançeskës

Shkup, 28 dhjetor - Drejtoria e Policisë Financiare e Maqedonisë ngriti padi penale kundër ish-ministres së Kulturës, Elizabeta Kançeska-Milevska, zëvendësit të saj Dragan Nedellkoviç dhe kundër Gj.T., këshilltarit shtetëror për çështje financiare dhe udhëheqës në sektorin për financa në Ministrinë e Kulturës. Ata dyshohen për veprën penale "Punë e pandërgjegjshme në shërbim" dhe shkaktimin e dëmit në Buxhet në shumën prej 170.671.444 denarë ose 2.770.640 euro. Siç thuhet në kumtesën e Drejtorisë, në periudhën nga korriku i vitit 2009 deri në shkurt të vitit 2017 tre të dyshuarit duke shmangur mbikë-

qyrjen e obligueshme në mënyrë të pandërgjegjshme kanë vepruar në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të tyre, në mënyrë që në kundërshtim me nenin 581 paragrafi 2 nga Ligji për shoqëritë tregtare, që në mënyrë të saktë thekson se kompanitë e huaja nuk mund të ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë derisa nuk organizojnë filiale, kanë pranuar fatura nga subjekti juridik i huaj 'Svetlost Teatar SHPK Beograd', i cili nuk është regjistruar si tatimpagues në Republikën e Maqedonisë. Në të është përfshinë në mënyrë të paligjshme një shumë shtesë e paraqitur si TVSH prej 18 për qind, me



ç'rast ministrja dhe zëvendësmministri kanë nënshkruar gjashtëdhjetë e katër vendime për përktim të mjeteve, ndërsa udhëheqësi i sektorit të punëve financiare nënshkroi urdhëresa për pagesë të fondeve në dëm të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, me të cilat kanë bërë pagesa jashtë shtetit në bazë të 11 marrëveshjeve për kryerjen e shërbimeve, mallrave dhe punëve.

## KRONIKË

### Aksident në Milladinoc, humb jetën 19-vjeçari

Një 19-vjeçar nga Milladinoci i Shkupit mëngjesin e djeshëm humbi jetën në një aksident trafiku në aksin lokal nga lagja Ilinden drejt Milladinocit, njofton MPB-ja. Aksidenti është denoncuar në orën 06:45. Automjeti i udhëtarëve "golf" me targa të Shkupit i drejtuar nga A.Z. (19) ka dalë nga rruga dhe është përmbysur. Nga lëndimet e marra shoferi ka ndërruar jetë në vendin e aksidentit. Mjeku nga Ndhma urgjente mjekësore ka konstatuar vdekjen. Është njoftuar prokurori publik dhe për momentin por realizohet ekspertizë nga ekipi i ekspertëve. Po punohet në ndriçimin e plotë të rastit.

### Çegran, zbulohen 13 këngëtare dhe valltare

Policia e Gostivarit në një lokal në fshatin Çegran i kapi më shumë gra, të cilat ilegalisht kanë punuar si këngëtare dhe valltare. Nga SPB Tetovë informojnë se në periudhën prej orës dy deri në katër pas mesnate, është zbatuar kontroll në objektin hotilerik "Bake-kom SHPKNJ" në pronë të A.N (47) nga ky fshat. Gjatë kontrollit, i cili është zbatuar në koordinim me Sektorin për krim ndërkufitar, migracion, të huaj dhe riatdhësim, në objekt janë kapur 13 gra, këngëtare dhe valltare, prej të cilave 10-të shqiptare dhe tre shtetase të Maqedonisë. Për shkak keqpërdorimit të qëndrimit turistik, shtetaset e huaja janë arrestuar dhe mbajtur në Stacionin policor në Gostivar për procedurë të mëtejme, derisa shtetaset e Maqedonisë, pas një kohe të shkurtër janë lëshuar.

### Plagos me thikë fqiu për parking

Të mërkurën mbrëma rreth orës 22.45 minuta në spitalin e Gostivarit është sjellë 63-vjeçari me iniciale V.S nga fshati Vrapçisht i Gostivarit me një plagë në bark të shkaktuar nga thika. Pas dhënies së Ndhmës së Parë në Spitalin e Gostivarit, menjëherë është transferuar për në klinikat e Shkupit. Plagën në bark rreth 20 minuta për parë para se të sillej në spital dyshohet se me një thikë kuzhine ia ka shkaktuar fqiu i tij, 68-vjeçari me iniciale A.A nga i njëjti fshat. Dy fqinjët fillimisht janë zënë verbalisht përpara shtëpisë së A.A rreth një furgoni të parkuar, pas çka A.A ka hyrë në shtëpi dhe ka marrë një thikë me të cilën e ka plagosur V.S-në. I dyshuari A.A është arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor të Gostivarit. Po punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

### Shkup, një i vdekur dhe dy të lënduar rëndë në aksidente

Një person e ka humbur jetën në një nga gjithësej nëntë aksidentet e regjistruara gjatë 24 orëve të kaluara në rajonin e SPB Shkup. Në dy aksidente janë lënduar më rëndë dy persona, ndërsa tre persona janë lënduar më lehtë në një aksident trafiku. Në pesë aksidente janë shkaktuar dëme materiale. Nga MPB-ja informojnë se dje policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar disa kundërvajtje. Përsëmbëdhjetë shoferë kanë drejtuar automjetin me shtëptësi më të madhe se e lejuara dhe një shofer i cili ka kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe. Nga komunikacioni janë përjashtuar nëntë shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, si dhe shtatë shoferë me patentë shofer të skaduar. Janë sanksionuar 107 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt. Me ndihmën e automjetit special karrotrec, janë larguar 93 automjete. (O.Xh)

MASAT E REJA QEVERTARE TË PËRGJITHËSUARA, JO KONKRETE

# BIZNESET, SECILI KËRKON ILAÇ PËR HALLET E VETA

Sipas Menderez Kuçit, nuk mundet që çdo biznes në aspekt vetëm të interesit të tij, të kërkojë masa për zgjidhjen e problemeve në punët e tij të përditshme, por kërkesat duhet të vendosen sipas prioriteteve, sipas asaj se çka i nevojitet shtetit për të arritur me të vërtetë rritje ekonomike prej së paku 3 për qind

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 dhjetor - Një pjesë e afaristëve mirëpresin masat e reja qeveritare për rritjen ekonomike, bazimin e kushteve për investime për biznesin vendor dhe të jashtëm, përkrahjen e eksportit dhe mbështetjen më të madhe për kompanitë e vogla dhe të mesme, por megjithatë shtojnë se ato janë shumë të përgjithësuara dhe jo



shumë konkrete.

Sipas Menderez Kuçit, anëtar i Këshillit Drejtues të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore, mungon një strategji operative për realizimin e planit ekonomik qeveritar, për të cilin nuk e ka fajin vetëm ekzekutivi, por edhe të gjitha Odat Ekonomike për shkak se aktualisht - pjesa më e madhe e sektorëve në mënyrë individuale kërkon ilaç për problemet e veta duke filluar nga tekstili, turizmi apo komunikacioni.

"Nuk mundet që çdo biznes në aspekt vetëm të interesit të tij të kërkojë masa për zgjidhjen e pro-

blemeve në punën e tij të përditshme, por kërkesat duhet të vendosen sipas prioriteteve, sipas asaj

se çka i nevojitet shtetit për të arritur me të vërtetë rritje ekonomike prej së paku 3 për qind. Gjithashtu

## TRE SHTYLLAT E PLANIT TË RI EKONOMIK

Plani për rritje ekonomike bazohet në tre shtylla prej të cilave e para është për mbështetje të të gjithë operatorëve ekonomik, e dyta për kompanitë të cilat përfitojnë tregje të reja, ndërsa e treta u dedikohet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat mund t'i shfrytëzojnë edhe masat nga shtylla e parë dhe e dytë. Që t'i shfrytëzojë masat, çdo kompani duhet të ketë realizuar të ardhura më të mëdha vitin e kaluar nga tre vitet paraprake dhe të mos e zvogëlojë

numrin e të punësuarve. "Plani për rritje ekonomike është mbështetje e cila do të sigurojë rritje të ekonomisë dhe në qoftë se njihet nga investuesit pres që rritja e projektuar e BPV-së nga 3.2 për qind për vitin e ardhshëm të jetë më e lartë", thuhet në vendimin e Qeverisë, ndërsa shpresohet se me këtë plan, investuesit e huaj të cilët janë tanimë të pranishëm në vend, do të fitojnë mbështetje më të madhe nga paraprakisht.

PAGAT NË MAQEDONI

# MENAXHERI MË I PAGUAR FITON 210 MIJË EURO NË MUAJ

Për dallim prej disave që fitojnë me mijëra euro në muaj, pjesa dërmuese e të punësuarve në Maqedoni mesatarisht marrin pagë prej 200 deri 300 euro

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 dhjetor - Menaxherët e bankave, kompanive të naftës dhe hoteleve, renditen ndër më të paguarit në Maqedoni. Ato marrin pagat që lëvizin prej 150-200 mijë euro, tregojnë raportet vjetore për punën e institucioneve financiare në Maqedoni. Analizat tregojnë se sektorët më fitimprurës në Maqedoni, siç janë telekomunikacioni, bankat, teknologjia informatike, energjetika, industria automobilistike, farmacia, shpërblejnë më shumë menaxherët e tyre kryesor.

Rroga të larta në Maqedoni, por edhe në vendet e rajonit dhe më gjerë, marrin një numër i vogël i profesionistëve që kanë edhe



përgjegjësi të madhe për menaxhimin e bizneseve, sidomos në kushte të krizës politike, ekonomike dhe uljes së fuqisë blerëse në të gjithë Evropën Juglindore. Edhe

pse emrat e drejtuesve që marrin paga më të larta, janë fshehtësi profesionale dhe paraqesin sekret afarist jo vetëm në Maqedoni, por edhe në tërë botën, megjithatë, si-

pas të dhënave të Drejtorisë për të Ardhura Publike, vetëm një person në Maqedoni e ka pagën 210 mijë euro në muaj. Pagë më të lartë neto pagë se 14 mijë euro fitojnë 104 persona, ndërsa pagë prej 10 mijë deri 14 mijë euro fitojnë 50 persona. Pagë prej 5 deri 10 mijë euro fitojnë 221 të punësuar, ndërsa prej 2 deri 5 mijë euro 1522 të punësuar. Paga prej 1 mijë deri 2 mijë euro fitojnë 8128 të punësuar. Në ndërkohë, për dallim prej personave që fitojnë me mijëra euro në muaj, pjesa dërmuese e të punësuarve në Maqedoni, mesatarisht marrin pagë prej 200 deri 300 euro.

Rroga mesatare prej afër 23 mijë denarë ose saktësisht 22 912 denarë në muajin gusht, mbetet ëndërr e paarrtshme për gjysmën

e të punësuarve në Maqedoni. Sipas të dhënave të Entit të Statistikës për muajin gusht, afër 300 mijë të punësuar në industrinë përpunuese, bujqësi dhe ndërtimtari, marrin paga më të ulëta se ajo mesatare. Pagat mesatare në ndërtimtari janë 21 mijë denarë, në industrinë përpunuese dhe bujqësi 18 mijë denarë dhe në hoteleri 16 mijë denarë.

Sipas përfaqësuesve të biznesit dhe ekonomistëve, produktiviteti i ulët në përgjithësi i industrisë përpunuese në Maqedoni, ambienti jostabil me të cilin ndeshet biznesi, kërkesa më e madhe se oferta në tregun e punës, por edhe shpërndarja jo e barabartë e rritjes ekonomike për të gjithë qytetarët e Maqedonisë, janë ndër shkaqet kryesore pse gati gjysma e të punësuarve në Maqedoni nuk janë të paguar në nivel të shtetit. Punëdhënësit vlerësojnë se pas rritjes së pagës minimale në 12 mijë denarë, mund të pritet rritja edhe e pagës minimale, por vetëm me kusht shëndoshjes së ekonomisë dhe rritjes ekonomike më të madhe në Maqedoni. Ekonomistët thonë se te rritja e pagës një nga faktorët kryesorë, është produktiviteti i punëtorëve që në Maqedoni

## PAGA MESATARE NË MAQEDONI MË E ULËTA NË RAJON

Slovenia ka pagë më të lartë mesatare në rajon, ndërsa më të ulët në Maqedoni. Paga mesatare në Slloveni në tetor të këtij viti në Slloveni është 1056 euro, ndërsa në Maqedoni 381 euro, publikoi Anadolia. Në Kroaci paga mesatare ka qenë 795 euro, në Mal të Zi 511 euro, Bosnjë e Hercegovinë 436 euro, Serbi 396 euro. Gjatë vitit 2017 rritje më të madhe të pagës mesatare ka pasur në Kroaci për 45.83 euro, ndërsa më pak në Bosnjë e

Hercegovinë për 8.13 euro dhe Mal të Zi për tetë euro. Në Slloveni gjatë vitit 2017 paga mesatare është rritur për 36.07 euro, në Serbi për 26.59 euro dhe në Maqedoni 18.10 euro. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë të Republikës së Maqedonisë paga mesatare në tetor ka qenë 23.356 denarë, ndërsa mesatarja për nëntë muajt e parë të këtij viti 22.808 denarë.

rezultat mund të arrihet në praktikë nga masat e caktuara.

"Një nga mangësitë e këtij plani qeveritar është, për shembull, edhe anashkalimi i diasporës dhe potencialit të saj për të ndihmuar vendin lidhur me investimet në fusha të ndryshme, por edhe duke marrë në konsideratë potencialin e saj intelektual. Ose, pak flitet për promovimin dhe mbështetjen konkrete dhe më të madhe të kompanive eksportuese që të gjejnë tregje të reja", shton më tej Kuçi. Në ndërkohë, ekonomistët vlerësojnë se kushti i parë që duhet të realizohet që të mund të ketë rritje më të madhe ekonomike, është ruajtja e stabilitetit politik. Gjithashtu vlerësohet se do të duhet të realizohen reforma të thella dhe rrënjësore që të krijohen kushte për rritjen më të madhe të Prodhimit të Brendshëm Bruto, duke filluar nga gjyqësori, sundimi i së drejtës, qasjes më të lehtë ndaj financave për bizneset, arsimit dhe kështu me radhë. Pritshmëritë e ekspertëve ekonomik janë që rritja më e madhe ekonomike e që nënkupton edhe rritje të pagave dhe përmirësim të standardit, duhet të mbështet si nga konsumi personal i qytetarëve, ashtu edhe nga investimet që do të bëjnë kompanitë aktive në treg, si dhe firmat e reja që do të hapen. Masat pritet të hyjnë në fuqi prej muajit prill të vitit të ardhshëm, kur bizneset do të dorëzojnë llogaritë përfundimtare për vitin paraprak. Pas kësaj, ato do të mund të aplikojnë për masat e propozuara qeveritare për shfrytëzimin e mjeteve të pakthyeshme në të holla.

Ndryshe, për realizim të Programit për zhvillim ekonomik, për vitin 2018 janë caktuar 3.1 miliardë denarë ose rreth 50 milionë euro.

është ndër më të ulët në Evropë. Teknologjia e vjetër si dhe kuadri që nuk posedon shkathtësi të nevojshme që kërkohen në tregun e punës, renditen ndër shkaqet kryesore pse Maqedonia është ndër të fundit në listën e Eurostat lidhur me produktivitetin e punëtorëve.

Një punëtor në Maqedoni krijon vetëm 43.8 për qind të mesatares së vlerës së shtuar, që e krijojnë punëtorët në nivel të Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, ekonomistët thonë se në pagat e ulëta në rajon dhe në Maqedoni ndikojnë edhe perceptimi i lartë i mitës dhe korrupsioni, kapaciteti i ulët i administratës publike, papunësia e lartë, efikasiteti i ulët i gjyqësorit e kështu me radhë. Vlerësohet se ngecja e madhe e shteteve të rajonit në aspektin ekonomik dhe hapat e ngadalshëm në përmirësimin e standardit jetësor të qytetarëve, ndër lidhen me më shumë faktorë ku bëjnë pjesë edhe pasojat e krizave politike dhe luftërave të viteve 90-të, kapacitetet e dobëta administrative të shteteve që të krijojnë ambient të favorshëm për sipërmarrje dhe jo shtetet të jenë lojtarët kryesor në ekonomi, mungesa e stabilitetit politik për një kohë më të gjatë etj.

Qytetarët në Maqedoni mbeten të shpresojnë se me reformat më të guximshme ekonomike, shoqërore dhe politike, së paku do t'i afrohem suksesit të Rumanisë, e cila në vitin 2004 kur anëtarësua në BE, së bashku me Bullgarinë, ishin dy shtetet më të varfra dhe më të pakonsoliduara evropiane në aspektin e sundimit të ligjit, ndërsa tani kanë paga mesatare prej 515 euro. Në periudhën 2014-2017, në këto shtete, pagat janë rritur për 23 për qind.

## ROAMINGU NË RAJON PRET 2018-ËN

# ÇMIME MË TË LIRA PËR BISEDADA DHE MESAZHE

Përfaqësuesit bullgar në Bruksel kanë paralajmëruar uljen e mëtejshme të bisedave të ndërsjella në rajon për të gjitha shtetet. Ata angazhohen për uljen e tarifave për roamingun për shtetet e Ballkanit perëndimor si dhe në raport me BE-në

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 dhjetor - Konsumatorët në Maqedoni prej një korrikut të këtij viti shfrytëzojnë tarifa më të lira të roamingut me Malin e Zi, Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën dhe anashkalltas. Një minutë bisedë në roaming paguhet 11.6 denarë, për SMS mesazhet paguhet 3.7 denarë, ndërsa për megabajt internet paguhet 12.3 denarë. Kjo ishte ulja e tretë dhe e fundit e çmimit të roamingut celular, e parashikuar me marrëveshjen e nënshkruar midis katër shteteve të rajonit. Marrëveshje u arrit, me qëllim që të lirohen çmimet e roamingut në rajon që ishin shumë më të larta se çmimet në shtetet e Bashkimit Evropian. Në vitet e kaluara, sipas Agjencisë së Komunikimeve Elektronike të Maqedonisë, edhe pse të ftuara të nënshkruajnë një bashkëpunim të tillë për uljen e roamingut, në të nuk kanë marrë pjesë trupat rregullatorë të Kosovës dhe Shqipërisë.

Në ndërkohë, përfaqësuesit bullgar në Bruksel kanë paralajmëruar uljen e mëtejshme të bisedave të ndërsjella në rajon për të gjitha shtetet. "Angazhohem në idenë për uljen e tarifave për roamingun për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Tani është momenti. Kjo paraqet mundësi për Ballkanin, për BE-në dhe për Bullgarinë, e cila po ndërmerr kryesinë e Këshillit të Evropës në janar të vitit 2018", deklaroi para disa javësh Komisarja evropiane për digjitalizim, bullgarja, Marija Gabriel, në takimin e punës në Bruksel me deputetët e gjashtë shteteve ballkanike,

ndër të cilat ishte edhe Maqedonia.

Në ndërkohë, qeveritë e Maqedonisë dhe Bullgarisë, në muajin e kaluar në Strucicë nënshkruan memorandum për uljen e tarifave ndërkombëtare për roming në shërbimet e telekomunikacionit. Dokumenti mundëson që trupat rregullator të të dyja shteteve të fillojnë procedurë, me të cilën do të nxisin operatorët të nënshkruajnë marrëveshje për çmime më të lira për bisedada, mesazhe dhe internet në roaming.

Portali EurAktiv bëri të ditur muajin e kaluar se komisarja Gabriel, në samitin BE-Ballkani Perëndimor, në maj të vitit 2018 në Sofje, do të publikojë planin për anulimin e roamingut ndërmjet BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor. Pritet të paraqiten një sërë masash për zgjerimin e ndalesës për pagesë të roamingut të BE-së me Maqedoninë, Serbinë, Malin e Zi dhe Bosnje e Hercegovinën, ndërsa në këtë çështje punojnë një ekip juridik i Komisionit Evropian. Nuk bëhet e ditur se sa kohë do të duhet të kalojë përdërisa të hyjë në fuqi marrëveshja për anulimin e roamingut ndërmjet BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Nga Ministria e Jashtme bullgare kanë kumtuar se Bullgaria, pas Maqedonisë dhe Serbisë, negocion për nënshkrimin e roamingut edhe me Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Nga ana tjetër, bashkëngjitje e nismave rajonale për uljen e bisedave të ndërsjella në Ballkanin Perëndimor ka paralajmëruar edhe Shqipëria. Koordinatorja kombëtare për krijimin e zonës ekonomike rajonale bal-

lkanike, Milena Harito, thotë se ekziston një nismë konkrete në këtë drejtim për eliminimin e tarifave roaming ndërmjet 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Bashkimi Evropian nuk ka më tarifa suplementare, pra roaming është një lloj si komunikimet brenda çdo shteti. Ne duam të bëjmë të njëjtën gjë për gjashtë vendet e Ballkanit. Sipas konstatimit tonë, pjesa më e madhe e trafikut të operatorëve është midis vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të rajonit. Impakti nëse ne heqim tarifat e roamingut për vendet e rajonit nuk është shumë i lartë për operatorët, gjë që është normale. Qëllimi nuk është të dëmtohen operatorët, përkundrazi ata e zhvillojnë tregun. Por, qëllimi është që çdo njeri nga Shqipëria që shkon në Kosovë, apo çdo kosovar që vjen në Shqipëri, çdo serb që shkon në Mal të Zi të mos paguajë tarifë suplementare nga ajo që paguan kur është në vend të tij. Secili vend duhet të bëjë ndryshimet e veta dhe pastaj të gjashta vendet të bëjnë marrëveshje bilaterale për të ulur tarifat e roamingut", thekson Harito. Sipas saj, objektivi është miratimi i ligjit në Shqipëri brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2018. Ndryshe, ulja e çmimeve të roamingut, përveç që mbështet komunikacionin në të gjitha nivelet në rajonin midis qytetarëve dhe kompanive, është i imponuar edhe nga përdorimi masovik i qytetarëve të aplikacioneve të ndryshme si Fejsbuk, Vajber apo Mesenxher, për të cilat nevojitet vetëm internet falas, i cili nuk mungon në hapësirat publike të shteteve të ndryshme.

## SUGARESKI E PËRSËRIT: NË FUND TË 2018-ËS MUND TË FILLOJË AUTOSTRADA SHKUP-BLLACË

Shkup, 28 dhjetor - Ndërtimi i autostradës Shkup-Bllacë në gjatësi prej 13 kilometrave është prioritet kulmor për Qeverinë dhe për momentin bëhet riprojektim i dokumentacionit tanimë të përpunuar projektues me qëllim që të largohen parregullsitë dhe para fundit të vitit të ardhshëm të fillojë ndërtimi, paralajmëroi ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski. "Në vitin 2016 është nënshkruar marrëveshje për riprojektimin e autostradës, por që të mos na ndodhë ajo që ka

ndodhur me pjesët e tjera të autostradave, kemi vendosur t'i shikojmë të gjitha mundësitë dhe t'i mënjanojmë mangësitë të cilat eventualisht do të paraqiten në ndërtim.

Prandaj morëm rreth një milionë euro me të cilat duhet të bëhet riprojektim që të shmangen të gjitha lëshimet të cilat i kanë dokumentacionin projektues", tha Sugareski duke u përgjigjur në pyetje të deputetit Rexhep Memedi nga Lëvizja BESA, të vendosur në seancën e sotme të Kuvendit të dedikuar në pyetje të deputetëve. Ai theksoi se është paraprakë njoftim në trasenë e pjesës së autostradave në pjesën e zonave industriale dhe varrezat e reja që duhet të bëhen. Riprojektimi në dokumentacion, theksoi Sugareski, duhet të përfundojë gjatë vitit të ardhshëm që më pas të shpallet furnizim publik që do të përfundojë në afat të përshtatshëm dhe në fund të vitit 2018 të fillojë ndërtimi i autostradës dhe të ndërtohet me dinamikë të përfurcuar.

KREU I BFI-së DEKOROHET NGA PRESIDENTI AMERIKAN, DONALD TRAMP

# ÇMIM PRESIDENCIAL PËR REXHEPIN

Ceremonia për ndarjen e këtij çmimi u mbajt dje, ku përfaqësuesi nga Florida, Otto von Feigenblatt i dha çmimin Kreut të BFI-së në emër të presidentit Donald Tramp për arritje jetësore



Shkup, 28 dhjetor - Kryetari i Bashkësisë Islame në Maqedoni, H. Sulejman ef. Rexhepi, u dekorua me çmim presidencial, "Për arritje jetësore" e nënshkruar nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Tramp. Ceremonia për ndarjen e këtij çmimi u mbajt dje, ku përfaqësuesi nga Florida, Otto von Feigenblatt i dha çmimin Kreut të BFI-së në emër të presidentit Donald Tramp për arritje jetësore. Sipas Bashkësisë Islame ky çmim në Maqedoni është hera e parë që dikush e fiton.

Kreu i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi në fjalimin e tij falënderoi profesorin e marrëdhënieve ndërkombëtare në Florida, Otto von Feigenblatt i cili dha çmimin e firmosur nga presidenti Tramp. Rexhepi u shpreh se ky çmim për të nuk

është rastësishëm sepse SHBA-ja di t'i vlerësojë punët, të respektojë, të nderojë dhe shtet i cili di të mirëpresë dhe të ia shprehë mirënjohjet e veta secilit që angazhohet dhe përkujdeset për të mirat e të gjithëve dhe gjithsecilit që angazhohet për paqe, mirëqenie e tolerancë. "Ekselencës së tij dhe kryetar i SHBA-ve, i cili ka vlerësuar punën tonë, sukseset e arritura të miat jetësore, prandaj me një shprehje dhe me një fjalë, këtu para jush publikisht të them: Faleminderit! Faleminderit! Faleminderit! Tre herë. Këtë mirënjohje nuk e konsideroj si të rastësishme, por mbi të gjitha e shoh si një vlerësim të bashkëpunimit dhe të

bashkërendimit, të angazhimeve të përbashkëta në drejtim të lartësimit të vlerave të të dy popujve, popullit shqiptar dhe atij amerikan. E lus të Plotfuqishmin, Allahun ta bekojë popullin amerikan. Zoti i dhashtë jetë Presidentit, ekselencës së tij, Donald Trump që ta udhëheqë në rrugën e shëndoshë, me perspektivë - deklaroi Sulejman Rexhepi.

Prezent në këtë ceremoni ishin edhe muftiu i Tetovës, Qani Nesimi, kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, ambasadori i Shqipërisë në Shkup, Fatos Reka si dhe shumë personalitete të tjera publike.

## Problemi me korrupsionin eskaloi në Maqedoni

Shkup, 28 dhjetor - Problemi me korrupsionin eskaloi gjatë periudhës së kaluar në Maqedoni, e kjo është vërejtur si rënie më e madhe historike në listën e Indeksit për perceptimin e korrupsionit për vitin 2016, u publikua në raportin e Transparensi Interneshënëll - Maqedoni "Lufta kundër korrupsionit në Maqedoni në vitin 2017". Rezultati nga indeksi i perceptimit të korrupsionit (IKP) në vitin 2016 ka shënuar rënie frapante për 24 vende, ndërsa Maqedonia tani e zë vendin e ulët të 90-të nga gjithsej 176 shtete të radhitura, thuhet në raport. Lidhur me luftën kundër korrupsionit gjatë viteve të kaluara, thuhet se në RM më shumë vite udhëhiqej politikë e bazuar në klientelizëm dhe interese, vendësja e sistemit të shtetit të robëruar e ka pamundësuar punën e institucioneve të obliguar për luftë kundër korrupsionit, me çka u krijua sistem i fuqishëm i shprehur në mbrojtjen e të korrumpuarve dhe sistem i cili përkundër drejtësisë, sundojnë interesat. TI-Maqedoni njofton se indeksi i ri do të publikohet në vitin 2018, dhe se nevojitet aktivitet efikas në luftën kundër korrupsionit, ku do të përfshihen të gjithë aktorët, si dhe reformë e tërësishme e KSHPK. Lidhur me dorëheqjet në KSHZ, Transparensi Interneshënëll-Maqedoni njofton se ato janë hap pozitiv dhe domosdoshmërisht është të parandalohen keqpërdorime të tilla legale në të ardhmen, si dhe të zgjidhet problemi i ngjashëm me pagesën e mjeteve financiare për harxhimet e udhëtimit në Kuvend.

Publicitet

Në bazë të nenit 241 paragrafi (1) të Ligjit për siguri në komunikacion rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 169/15, 226/15 dhe 55/16) dhe nenit 50 të Rregullores për mënyrën e realizimit të provimeve për vozitje dhe kriteret e të përafërta në lidhje me kushtet hapësinore dhe pajisjeve materiale-teknike dhe informatike të qendrave për provim dhe mbajtjes së evidencave në lidhje me realizimin e provimeve për vozitje, si dhe mënyrën e dhënies dhe marrjes së licencës për qendër provimi, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës për qendër të provimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 139/16), Ministria e punëve të brendshme shpallë

### KONKURS PUBLIK PËR ZGJEDHJE TË SUBJEKTEVE JURIDIKE PËR MARRJE TË LICENCËS PËR QENDRA PROVIMI KUMANOVË, OHËR, TETOVË DHE SHTIP

I. Të drejtë për pjesëmarrje në konkursin publik për zgjedhje të personit juridik për marrje të licencës për Qendra për provim Kumanovë, Ohër, Tetovë dhe Shtip (në tekstin e mëtejshëm: "konkurs publik") ka çdo subjekt juridik, i cili i plotëson kushtet e parapara për punë me nenin 244 paragrafi (1) të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor, gjegjësisht:

- Të ketë kuadër profesional;
- Të ketë organizim të punës;
- Të ketë hapësira të rregulluara të pajisura me pajisje të posaçme (kamera) dhe kapacitete materiale-teknike;
- Të ketë autodrom komunikacioni (poligon) në seli dhe filiale në pronësi të së njëjtës qendër ose me qira, që përmbushë kushtet e parashtuara dhe elementet e komunikacionit dhe ato teknike;
- Të ketë pajisje informatike për kryerje të punëve të nevojshme dhe
- Të ketë makina të kategorive për të cilat qendra për provim është e autorizuar të kryejë testimin e kandidatëve për vozitës në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Krahas kushteve të theksuara me ligj, subjektet juridike duhet të përmbushin edhe kriteret më të përafërta të përcaktuara me nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Rregullores për mënyrën e realizimit të provimeve për vozitës dhe kriteret më të përafërta në lidhje me kushtet hapësinore dhe pasjeve materiale-teknike dhe informatike të qendrave për provim, mbajtje të evidencave në lidhje me provimet e realizuara për vozitës dhe për formën dhe përmbajtjen e licencës për qendër për provim, gjegjësisht:

- Qendra për provim duhet të posedojë hapësira dhe pajisje materiale-teknike të nevojshme për kryerje të punëve të organizimit dhe realizimit të provimeve për vozitës për kandidatët për vozitës në pronë të qendrës për provim ose me qira.
- Në selinë e qendrës për provim duhet të ketë hapësira të posaçme për punë administrative të referentëve dhe komisioneve të provimeve, hapësirë për punë të udhëheqësit, hapësirë për punë të kontrollorit dhe të punësuarve të tjerë në qendrën për provim.
- Paraqitjen e provimit për vozitës kandidatët e bëjnë në hapësira të posaçme për paraqitje (vende për paraqitje), të cilat

mund të jenë në pronësi të qendrës për provim ose me qira, të pajisura me pajisje informatike për paraqitje.

- Në selinë e qendrës për provim dhe në filialet e saj duhet të ketë hapësira të posaçme për mbajtjen e pjesës teorike të provimit për vozitës që sigurojnë kushtet për realizim të pjesës teorike të provimit për vozitës për së paku 30 kandidatë dhe të cilat duhet të jenë të pajisura me pajisje përkatëse informatike për realizim të pjesës teorike të provimit për vozitës për së paku 30 kandidatë për vozitës dhe të njëjtat mund të jenë në pronësi të qendrës për provim ose me qira. Në hapësirat duhet të vendoset edhe pajisja për video monitorim, e cila mundëson video procesim të realizimit të pjesës teorike të provimit për vozitës. Për sigurimin e video monitorimit, hapësira (klasa) duhet të jetë e pajisur me kamera të cilat në pajtim me dimensionet dhe karakteristikat e hapësirës do të mundësojnë video xhirime kualitative që mundësojnë njohje të kandidatëve për vozitës dhe komisionit të provimit, nga procesi i tërësishëm i realizimit të pjesës teorike të provimit për vozitës me mundësi për arkivim dhe dokumentim të materialit të xhiruar.

- Hapësira për realizim të pjesës teorike të provimit për vozitës (klasa) duhet të jetë me sipërfaqe prej së paku 1,5 m<sup>2</sup> për kandidatë për vozitës, gjegjësisht së paku pesë m<sup>2</sup> për komisionin e provimit, të pajisur me një tavolinë pune, një tabelë shkollore dhe mjete shkollore me mundësi për qartësim të mënyrës së realizimit të pjesës teorike të provimit për vozitës, ngrohje përkatëse, ventilim, ndriçim dhe pajisje sanitare.

- Qendra për provim duhet të posedojë pajisje informatike dhe aplikacione të licencuara përkatëse softuerike që mundësojnë realizim të provimit për vozitës, si dhe qasje për shfrytëzim të aplikacioneve për realizim të dhënies elektronike të pjesës teorike të provimit për vozitës dhe lidhje interneti në seli të qendrës për provim dhe në filialet prej së paku 4 mb/s të përshtatshëm kryesisht për dhënie elektronike të pjesës teorike të provimit për vozitës.

II. Numri minimal i komisioneve për provim për rajonin e qendrës për provim në Kumanovë, me vend për provim në Kumanovë dhe filial dhe vendin për provim në Kriva Pallankë është së paku dy komisione me vende për paraqitje në Kumanovë, Kriva Pallankë dhe Kratovë.

Numri minimal i komisioneve për provim për rajonin e qendrës për provim në Ohër, me vend për provim në Ohër dhe

filial dhe vendin për provim në Strugë, Kërçovë dhe Dibër është së paku dy komisione me vende për paraqitje në Ohër, Kërçovë dhe Dibër.

Numri minimal i komisioneve për provim për rajonin e qendrës për provim në Tetovë, me vend për provim në Tetovë dhe filial dhe vendin për provim në Gostivar është së paku tre komisione me vende për paraqitje në Tetovë dhe Gostivar.

Numri minimal i komisioneve për provim për rajonin e qendrës për provim në Shtip, me vend për provim në Shtip dhe filial dhe vendin për provim në Sveti Nikole, Probishtip, Koçan, Dellçevë dhe Berovë është së paku tre komisione me vende për paraqitje në Sveti Nikole, Probishtip, Koçan, Dellçevë dhe Berovë.

III. Pjesëmarrësit në konkursin publik duhet të parashtojnë kërkesë dhe dokumente për përmbushjen e kushteve për kryerje të punëve të qendrës për provim në pajtim me ligjin, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të konkursit publik, deri në Ministrinë e punëve të brendshme, rr. "Dimçe Mirçev" nr. 9, 1000 Shkup.

IV. Zgjedhja e subjekteve juridike i cili do të marrë licencë për Qendër për provim Kumanovë, Ohër, Tetovë dhe Shtip do të kryhet nga pjesëmarrësit e paraqitur në konkursin publik të cilët i plotësojnë kushtet nga pjesa e I të këtij konkursi publik, nga ana e Komisionit të Ministrisë së punëve të brendshme e formuar në pajtim me nenin 50 paragrafi (2) e Rregullores për mënyrën e zbatimit të provimit për vozitës dhe kriteret e përafërta në lidhje me kushtet hapësinore dhe material-teknike dhe pajisje informatike të qendrave për provim dhe mbajtjen e evidencave në lidhje me provimet e zbatuara për vozitës si dhe për formën dhënies dhe marrjes së licencës për qendër për provim, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës për qendër për provim.

V. Në afat prej 15 ditë nga zbatimi për zgjedhjen e subjektit juridik, Ministria e punëve të brendshme do ta autorizojë Qendrat për provim Kumanovë, Ohër, Tetovë dhe Shtip në pajtim me organizimin e njësisë përkatëse organizative-Sektoret për punë të brendshme të Ministrisë edhe atë Qendër për provim me seli në Kumanovë, Ohër, Tetovë dhe Shtip.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME



Bëhet fjalë për një publikim që përfshin punën e këtij institucioni që nga themelimi, botimet, konferencat dhe aktivitetet e zhvilluara, drejtuesit dhe punonjësit shkencorë që kanë kontribuar gjatë këtyre viteve, vlerësimet e dhëna, e të tjera. Sa i takon arritjeve gjatë një dekade, monografia nxjerr në spikamë aktivitetin botues, por edhe mosmarrëveshjet politike që kanë stanguar ecurinë normale të këtij institucioni

INSTITUTI SHËNON PËRVJETORIN



DHJETË VJET ITSHKSH NË NJË MONOGRAFI

lumtuese të zhvendoset në fokus të veprimtarisë së tij.

“Për një dekadë punë, Instituti ynë po e arrin numrin trashëfitor në botimin e veprave shkencore. Me sukses po botohet ‘Studime albanologjike’, që shënon një arritje të rëndësishme dhe njëherësh një kontribut me vlerë të çmueshme në shkencat e albanologjisë. Përmes shkrimeve analitike hidhet dritë mbi ngjarjet historike, gjuhësore, etnologjike, dhe në përgjithësi të trashëgimisë tonë të pasur kulturore”, thuhet në monografi. Vitet e para pas themelimit, janë të përmblendhura së bashku, 2007-2011 dhe përshkruhen me një veprimtari të kufizuar, si Akademi shkencore me rastin e shënimit të vitit jubilar të vdekjes së heroit kombëtar

Gjergj Kastriotit - Skënderbeut (2008) dhe Lidhjes së Prizrenit, fillimi i botimit të “Studimeve Albanologjike” (2009), Marrëveshja e bashkëpunimit me USHT (2010). Në vitin 2011 veçohet themelimi i biblio-

tekës dhe sesioni shkencor për mbrojtjen e trashëgimisë, si edhe vizita në monumentet historike dhe kulturore në Dibër. Periudha 2012-2017 shënon një epokë ndryshe. Ajo është e pasqyruar veçmas për çdo vit dhe përfshihen në mënyrë më të detajuar aktivitetet e këtij institucioni.

Ideja e monografisë “10 Vjet ITSHKSH” është që të prezantohet rrugëtimi i këtij institucioni ku shpeshherë është sfiduar nga rrethanat shoqërore e politike të kohës, por që vazhdon të jep frytet e tij, duke e arsyetuar misionin themeltar, sqaron drejtori i ITSHKSH, Skënder Asani. Sipas tij modeli i funksionimit që ka krijuar instituti ka reflektuar në qarqet shkencore, duke qenë pionier në paraqitjen e diversiteteve si pasuri kombëtare e shtetërore dhe në përafrimin etnik dhe fetar.

“Në këtë dhjetëvjetor, shkurtazi po i potencojmë edhe shqetësimet që i ka pasur ky Institut shqiptar herë pas here gjatë rrugëtimin të tij. Një

theks i veçantë duhet vënë në fërkiemet e subjekteve politike shqiptare, se ky projekt madhor për popullin shqiptar në Maqedoni, është themeluar nga një subjekt tjetër politik, prandaj edhe shpeshherë ka munguar një përkrahje e merituar nga përfaqësuesit shqiptarë nëpër institucionet tona shtetërore”, ka thënë drejtori Asani.

Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, ka premtuar mbështetjen e MASH gjatë viteve në vazhdim. “Ne të gjithë presim që në ardhmen, nga ky Institut të dalin edhe rezultate të reja për fusha të caktuara të shkencës shqiptare. Presim që këto rezultate të prezantohen jo vetëm se këtu në Maqedoni, por edhe në rajon dhe në botë, duke kontribuar edhe në promovimin e vlerave tona të lashta si komb dhe si shoqëri në përgjithësi”, ka thënë Ademi. Në këtë aktivitetin me rastin e botimit të monografisë janë lexuar edhe telegrame urimi nga akademikë nga Prishtina e Tirana.

Plagoset nga hajnat duke mbrojtur shtëpinë

Gostivar, 28 dhjetor - Të mërkurën mbrëma rreth orës 20.40 minuta, tre persona të maskuar deri më tani të pa identifikuar, nga të cilët njëri i armatosur me pistoletë, kanë kryer plaçkitje në shtëpinë e 67-vjeçarit R.E nga Gostivari në rrugën “Vëllezërit Bllazhevski” në Gostivar. Pasi i kanë rënë ziles së derës, R.E duke menduar se është djali i tij është drejtuar në drejtim të derës hyrëse, dhe në momentin kur ka hapur derën njëri prej të maskuarve është hedhur në drejtim të tij dhe me grushte e ka goditur në fytyrë, pas çka R.E ka rënë në tokë, por menjëherë është ngritur dhe është munduar që të bëjë rezistencë. Personi me pistoletën në dorë ka gjuajtur një plumb dhe e ka goditur në dorën e djathtë, duke i shkaktuar plagë, ndërsa më pas tre të maskuarit kanë ikur nga shtëpia. I lënduari R.E është dërguar në Spitalin e Gostivarit ku i është ofruar ndihma e parë dhe më pas është transferuar në klinikat e Shkupit. Prokurori publik si dhe një ekip nga Sektori për punë të brendshme në Tetovë, stacioni policor i Gostivarit kanë kryer një ekspertizë të kompletuar në vendin e ngjarjes dhe po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e rastit të denoncuar si dhe zbulimin e autorëve të kësaj plaçkitjeje. (U.H)

Koha Halili

Shkup, 28 dhjetor - Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore ka botuar një monografi me rastin e dhjetëvjetorit të themelimit. Bëhet fjalë për një publikim që përfshin punën e këtij institucioni që nga themelimi, botimet, konferencat dhe aktivitetet e zhvilluara, drejtuesit dhe punonjësit shkencorë që kanë kontribuar gjatë këtyre viteve, vlerësimet e dhëna, e të tjera. Sa i takon arritjeve gjatë një dekade, monografia nxjerr në spikamë aktivitetin botues, konferenca shkencore të organizuara, brenda dhe jashtë vendit. Sa i takon aktivitetit hulumtues ky institucion është ende në fillimet e tij. Por që sipas projekteve që janë duke u përgatitur gjatë viteve në vazhdim priten që veprimtaria hu-

REAGJONË AMBIENTALISTËT E TETOVËS  
KOMUNA DUARKRYQ PËR NDOTJEN

Tetovë, 28 dhjetor - Lëvizja Eco Guerrilla ka reaguar ndaj rritjes së nivelit të ndotjes kohëve të fundit në Tetovë dhe rrethinë. Sipas Arianit Xhaferit, kryetar i Lëvizjes Eco Guerrilla, në mungesë të masave dhe rekomandimeve që duhet të ndërmerren nga Komuna e Tetovës për të zbutur dhe për të zgjidhur problemin me ndotjen e ajrit në Tetovë, i ka bërë thirrje qytetarëve të Tetovës që gjatë këtyre ditëve - sipas mundësive të kufizojnë sa më shumë lëvizjen me veturat e tyre. “Si pasojë e keqmenaxhimit nga Komuna e Tetovës që për vite me radhë na la pa transportin publik, pa parkingje nëntokësore ose në kate, pa zhbllokimin e bulevardeve kryesore dhe me neglizhencën e

Inspektoratit ekologjik komunal për të parandaluar ndërmarrjet që ndotin, tetovarët gjatë viteve të fundit ekspozohen në ndotje ekstreme të ajrit me pasoja serioze për shëndetin dhe jetën e qytetarëve, posaçërisht të fëmijëve”, tha ai. Arianit Xhaferi më tej shton se Tetova është qytet që ngrohjen - diku rreth 80 apo 90 për qind e ka me dru. Në ditët e ftohta të dimrit, kur edhe procesi inverziv i shtypjes së ajrit është i ulët, shkaktar tjetër për ndotje është edhe ngrohja me dru, shton Xhaferi. “Mungesa e alternativave tjera për ngrohje, si ajo me gaz apo energji të tjera alternative, janë rezultati i paaftësisë së pushtetit lokal dhe atij qendror që me vite nuk zgjidhën këtë problem

serioz për qytetarët. Presim nga Komuna e Tetovës që të pastrojë rrugët e stërmbushura me pluhur, pasi aty më së shumti gjinden grimcat PM10. Largimi i veturave të havarisura dhe të paregjistruara që bllokojnë rrugët, trotualet dhe hapësirat publike po ashtu është detyrim ligjor i Komunës, gjë që deri më sot nuk është realizuar. Mos hapja e qarkores së qytetit e cila do lidhte fshatrat në drejtimin Porroj-Jazhincë është një problem i vazhdueshëm për trafikun e stërngarkuar të Tetovës”, deklaroi kreu i Eco Guerrillës, Arianit Xhaferi. Ka reaguar edhe Lëvizja “Nëna dhe Fëmija”. Ata thonë se ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor - bazuar në



informatat e Sistemit Shtetëror të Monitorimit Automatik të Cilësisë së Ajrit të Ambientit dhe parashikimit të marrë të motit nga Enti Hidrometeorologjik, informoi që pragu i alarmimit për PM10 është tejkaluar në Shkup dhe në Tetovë. Në pajtim me konkluzionet nga mbledhja e 40-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të mbajtur më

28.11.2017, duhet të hynë në fuqi masat urgjente. Me këtë rast, Lëvizja “Nëna dhe Fëmija”, kërkon nga Komuna e Tetovës të informojë qytetarët për veprimet dhe masat urgjente që janë marrë në këtë komunë dhe njëherësh informon banorët që Tetova është komuna e vetme në Maqedoni që, edhe pas reshjeve të shumta, vazhdon të jetë e ndotur. (U.H)

LETËR E HAPUR GJYKATËSIT BEQIR KALLUDRA

# Procesi i palogjikshëm kundër deputetëve të Vetëvendosjes



Nga Uk LUSHI

I nderuar Gjykatës Kalludra, përdërisa jemi vetëm dy-tri ditë larg ndërrimit të motmoteve, në radhë të parë dua t'ju shpreh dëshirat e mia më të mira për Vitin e Ri 2018. Mund ta marr me mend sa të bukura do të jenë e krenjtja dhe dhuratat që do të shkëmbeni me familjarët dhe shokët tuaj. Por këtë mundësi festimi dhe gëzimi, për shkak të vendimit tuaj t'i mbani në paraburgim për një rast diskutabil, nuk do ta kenë Donika Kadaj-Bujupi dhe Albin Kurti, dy prindër si ju dhe përfaqësues kuvendorë të popullit të Kosovës.

I nderuar Gjykatës, që të zhdruk çfarëdo paragjykimi, para se të rreshtoj mendimet dhe argumentet e mia lidhur me mosarsyen e mbajtjes në burg, që unë e cilësoj si të padrejtë, të zonjës Kadaj-Bujupi dhe zotit Kurti, me krenari deklaroj respektin tim më të lartë për gjyqtarët dhe pohoj rëndësinë e gjyqësisë në shoqëri dhe shtet. Poashtu, lejomëni t'ju informoj, që, nuk jam anëtar i organizatës Lëvizja Vetëvendosje, në dhe përmes së cilës veprojnë si aktivistë politikë të dy të burgosur tuaj.

E them pa mëdyshje, po të kisha qenë unë në vendin e tyre dhe deputetëve të opozitës në Kuvendin e Kosovës në vitet 2015-16, nuk do të kisha hedhur gaz lotsjellës si mjet politik. Mirëpo ky vlerësim imi nuk mundet ta delegitimojë ose gjykojë të drejtën e përdorimit të një metode politike - të pakëndshme por të tolerueshme - nga persona gjegjësisht subjekte politike.

Ç' është më me rëndësi, legjitimitetin e një veprimi politik nuk mund ta gjykoni as ju dhe asnjë gjykatës legal askund në botë. Gjykatësi i vetëm që duhet dhe mund të jep verdikte për sjellje politike është sovran.

Gjykatës Kalludra, sipas mendimit tim, gabimin e parë formal ju dhe Gjykata Themelore e Prishtinës e keni bërë duke pranuar që ju të jeni gjyqtar i rastit lidhur me hedhjen e lotsjellësit në ambientet e Kuvendit ndërsa ju keni mbikëqyrë gjykimin dhe marrë vendim për dënimin me 21 vjet dhe gjashtë muaj burg për tre aktivistë dhe një deputet të VV-së për sulm kundër ndërtesës së Kuvendit. Nëse nuk jam gabim, Gjykata Themelore e Prishtinës ka 65 gjyqtarë tjerë dhe mosmarrja juaj me rastin e lotsjellës-gjuajtësve do të kishte vrarë dyshimet për konflikt interesi, ndërkaq

që do të ishte mundësuar detashmenti minimal juridik. Po përmend këtë lëshim (të rëndë) procedural, sepse ju po mbani në burg Kadaj-Bujupin dhe Kurtin pikërisht duke përdoruar rregullat procedurale të ndëshkimit për personat që nuk u përgjigjen thirrjeve dhe urdhrave gjyqësorë. Sido që të jetë, para se të paraqes mendimet dhe argumentet e mia pse krejt rasti është i pagjykueshëm dhe një parodi juridike, le të supozojmë për një çast, që, proceduralisht, ju po zbatoni ligjin dhe keni dashur të jepni një leksion për mosrespektimin e gjykatës dhe thirrjeve të saj nga ana e Kadaj-Bujupit dhe Kurtit. Dy të pandehurit janë në burg më shumë se një muaj tashmë dhe vazhdimi i paraburgimit për deputetët është masë disproporcionale për një shkelje joserioze. Paramendoni nëse një qytetar do të dënohej me 100 vjet burgim për një kundërvajtje komunikacioni. Dënimin i shpërpjestueshëm dhe përdorimi arbitrar i fuqisë suaj si gjykatës, kontribuon vetëm në zbehjen e besimit qytetar në paanësinë e nevojshme të drejtësisë dhe nuk sjell asnjë të mirë juridike dhe as shoqërore.

I nderuar Gjykatës Kalludra, zonja Kadaj-Bujupi dhe zoti Kurti duhet të lirohen sa më parë nga ju, nëse ende jo për mungesë meritash juridike të akuzave kundër tyre dhe bashkëkomplotistëve nga VV-ja, AAK-ja dhe Nisma, për të cilat gjithmonë ekziston opsioni të testohen në gjykim, atëherë, gjithsesi, për arsye trajtimi të barabartë për Kadaj-Bujupin dhe Kurtin që të kenë të drejtën të mbrohen në liri si 27-28 pjesëmarrësit tjerë në vepër, qofshin kryerës të akuzës së aluduar respektivisht fajtorë, qofshin aksesorë në komplot respektivisht bashkëfajtorë.

Gjykatës Kalludra, njëri nga pjesëmarrësit e atëbotshëm të ndërmarrjes, sipas jush, penale, zoti Ramush Haradinaj, sot, është kryeministër i Republikës. A do të gjykoni, ju apo Departamenti për Krim të Rënda, i nderuar ndarës i drejtësisë, edhe kryeministrin Haradinaj apo zv.kryeministrin Fatmir Limaj? Po ministrin Pal Lekaj? Po 25 ish- apo deputetët aktualë që ishin pjesë e gaz-hedhjes? Që një akt të konsiderohet penal (actus reus), zakonisht, doemos, duhet të shoqërohet me një motiv apo qëllim kri-

**I nderuar Gjykatës Kalludra, zonja Kadaj-Bujupi dhe zoti Kurti duhet të lirohen sa më parë nga ju, nëse ende jo për mungesë meritash juridike të akuzave kundër tyre dhe bashkëkomplotistëve nga VV-ja, AAK-ja dhe Nisma, për të cilat gjithmonë ekziston opsioni të testohen në gjykim, atëherë, gjithsesi, për arsye trajtimi të barabartë për Kadaj-Bujupin dhe Kurtin që të kenë të drejtën të mbrohen në liri si 27-28 pjesëmarrësit tjerë në vepër, qofshin kryerës të akuzës së aluduar respektivisht fajtorë, qofshin aksesorë në komplot respektivisht bashkëfajtorë**



minal (mens rea). Ndonëse çdo krim është shkelje ligji, jo çdo shkelje ligji është krim. Në aktet politike të hedhjes së gazit në parlament nuk ka motive dhe interesa kriminale. Më e shumta që mund të kërkohet juridikisht në këtë lëndë është zhdëmtim civil nga të pranishmit në sallën e mbledhjeve, por dhe kjo është shumë vështirë e realizueshme. Deputetët opozitarë në vitet 2015 dhe 2016, gjatë hedhjes së gazit, kanë vepruar politikisht dhe bile me 23 dhjetor 2015 kanë marrë përligje të fuqishme juridike dhe kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e cila, në aktgjykimin e saj, ka konstatuar 24 shkelje ose mospërputhje kushtetuese në draftet dhe dokumentet e projektit për Bashkësinë së Komunave të Kosovës me popullatë etnike shumicë serbe, e cila ka qenë një ndër dy arsyet e këmbënguljes kundërshtuese të opozitës dhe ndezjes së boçave të lotsjellësit në Kuvend.

Pra, janë dy rrafshet ku ju nuk mund operoni si gjykatës;

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovësja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 28 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
 Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

ai politik dhe ai kushtetues, dhe së këndejmi, nuk ka asnjë logjikë të vazhdohet procesi për lotsjellësin. Në të vërtetë, procedimi i mëtutjeshëm u fut ju personalisht në ujëra të kalimit të kompetencave tuaja kurse Gjykatën Themelore në territorin e tejkalimit të fuqive juridike dhe juridiksionale. Për më keq, marrja juaj dhe sistemit të drejtësisë me rastin rrezikon të ndikojë në proceset politike dhe partiake dhe kështu, ju dhe gjykata, nga gardianë të interesit kolektiv shndërroheni në influencues dhe përcaktues të zhvillimeve politike dhe partiake, sidomos marrë parasysh situatën e rëndë që e pret Kosovën 18-36 muajt e ardhshëm dhe pas shpalljes së zotit Kurti se do të garojë për (ri)zgjedhje si kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje.

I nderuar Gjykatës Kalludra, shteti ynë është krijuar me sakrificë të mëdha, pas vuajtjes së mijëra vjet burg të qytetarëve të Kosovës të kaluara në kazamatat e pushtuesit tonë ish-Jugosllavisë. Ne të gjithë e kemi bërë shtetin që ai të jetë mbrojtësi dhe trajtuesi fer dhe i drejtë për të gjithë, si ata që mendojnë dhe operojnë politikisht si ne, si ata që përdorin mendime dhe veprime të ndryshme nga tonat. Sigurisht që legaliteti i ligjit duhet respektuar dhe kur nuk respektohet ndëshkimet përkatëse duhet aplikuar, porse në rastin e lotsjellësit ju keni dalur jashtë konturave. Nëse dikush nga politika apo segmente të errëta ju ndikon apo u bën trysni, ju duhet të flisni publikisht, dhe, assesi s' duhet të pranoni të përkulni kurrizin sepse kurrizi i përkulur i gjykatësve është fillimi i rrëshqitjes drejt vdekjes i çdo shoqërie, shteti dhe populli. Drejtësia jonë ka të bëjë aq shumë punë me rastet e të miturve, dhunës në familje, korrupsionit dhe vrasjeve. Përqendrohuni atje - ju dhe gjykatat tona.

I nderuar Gjykatës Beqir Kalludra, ju lutem merrni parasysh mendimet dhe argumentet e mësipërme nga një qytetar i Republikës së Kosovës dhe duke përdorur edhe ndjeshmërinë njerëzore, një komponentë e gjyqtarisë prej kohëve më të lashta, lironi nga paraburgimi dhe burgu bashkëqytetarët tonë, Donika Kada-Bujupi dhe Albin Kurti. Ju siguroj që votuesit janë dhe do të jenë gjykatësit më të mirë të mundshëm për politikanët, si për t'i dënuar si për t'i shpërblyer. Na lejoni ne të vendosim për përfaqësuesit tonë. Shpresoj që do të veproni para natës madhështore të motmotndërrimit dhe zonja Kadaj-Bujupi dhe zoti Kurti do të mund të kalojnë, si ju, festimin e ardhjes së Vitit të Ri bashkë me fëmijët e tyre, familjet dhe miqtë e tyre.

## NË SHIRITIN E KOHËS

## Shkrirja e dialekteve të shqipes

Nga Faik KONICA



Duke studiuar, qoftë edhe shkurtimisht, natyrën e gegërishtes e të toskërishtes, menjëherë bie në sy se ndryshimi që i ndan nuk është më i madh se ai që shquan mënyrën e të folurit të një Normandi nga ajo e një Gaskoni. Do të thotë se në thelb ky ndryshim kufizohet në disa ngjyrime shqiptimi. Por në një vend ku mungon një traditë shkollore, këto ndryshime shqiptimi më tepër janë theksuar sesa janë zbutur; dhe shqiptarët, duke mos pasur si udhëheqës drejtshkrimorë as fjalorë, as akademi, ka rrjedhur që - kur ua ka marrë mendja të lëvrojnë gjuhën e vet - nuk kanë ndjekur rregulla të tjera drejtshkrimore, përveç atyre të transkriptimit të fjalëve ashtu si shqiptohen. Kështu, sikur t'ua jepnit sot një shqiptari të veriut dhe një shqiptari të jugut një tekst për ta përkthyer, do të kishit dy përkthime, gjuha e të cilave, në pikëpamje morfologjike, do të ndryshonte po aq sa ndryshon spanjishtja nga italishtja.

As rreziku i bashkëjetesës së këtyre dy dialekteve të përkundërt, as vështirësia për t'i shkrirë, nuk do t' u shpëtonin shqiptarëve të cilët janë të pajisur me njëfarë mendjemprehtësie. Çështja nuk qëndron a të zhduket gegërishtja apo toskërishtja, as madje të bëhet që shqiptarët të ndryshojnë, në përdorimin e përditshëm, dialektet e

**Zgjidhja më e mirë e problemit, ajo më praktike, do të ishte krijimi i një gramatike të miratuar nga shqiptarët e shkolluar dhe nga albanologët - në të cilën të gjitha elementet dialektore, të grupuara, të pajtuara, të bashkërenditura, sipas një metode racionale e shkencore, do të lindnin një gjuhë të përbashkët për të gjithë shqiptarët, sikurse grekët që kanë Koïnë glôssa**

tyre përkatëse për të arritur te njëfarë njësie të foluri; gjë e pamundur. Përveç kësaj kjo do të ishte ngathtësi, sepse të duash të ndryshosh të folmen e një populli, do të thotë të ndryshosh karakterin e tij e të shkatërrosh personalitetin e tij. Çështja qëndron te fakti që të arrihet të krijohet, përtej bashkëjetesës paralele të të folmeve toske e gege, një gjuhë letrare, një gjuhë e shkruar që të jetë e përbashkët për të gjithë shqiptarët.

Po t'ua vinim veshin disa shqiptarëve të shkolluar të cilëve ua kemi kërkuar mendimin, çështja as duhet parashtruar. Sipas mendimit të tyre, do të vijë një ditë në të cilën dialekti toskë - posa të arrijë, nëpër një zhvillim që ne e shohim çdo ditë në përparim, te lartësia e gjuhëve të mëdha moderne - ka për ta thithur në mënyrë të pashmangshme dialektin gegë, që ka qëndruar i palëvruar; dhe ata cekun, në mbështetje të mendimit të tyre, këtë fakt, në vetvete të saktë, se shumë shqiptarë-gegë përdorin toskërishten kur shkruajnë. Por ne nuk e përkrahim këtë mendim; sepse, ndonëse fakti që ata sjellin nuk na duket fort bindës, dialekti gegë përmban me qindra trajta të humbura nga toskët e që janë visare të vërteta të trashëguara nga të parët tanë të lashtësisë. Mjaft të sjellim në mend mbaresën -mun të pjesores gege, që daton së paku dy mijë vjet, e që s' është gjë tjetër veç-

se-m noV i pjesores greke (khs. shkërumun, gegramm noV). Ndoshta çështja mund të kishte një zgjidhje të lehtë e të shpejtë, po që se toskërishtja do të ruhej si gjuhë e prozës dhe gegërishtja e poezisë. Karakteri përkatës i dy dialekteve padyshim do të rregullohej në këtë rol. Ecja e gjerë dhe fisnike, ndonëse pak e lakueshme, e gegërishtes duket se i përshtatet ritmit të mendimeve e të ndjenjave.

Tash vonë kemi botuar (A. 91) një tingëllim të mrekullueshëm, i pari në gjuhën tonë, prej një autori të ri shkollor, i cili jep një ide të asaj që mund të bëhet dialekti gegë ndër duar të afta. Herën e fundit kemi botuar dy tingëllime të tjera, prapë të një autori gegë, bukuria e fuqishme e të cilave e vërteton këtë përshtypje. Por, të thuash të drejtën, realizimi i këtij mendimi nuk do të ishte i mundur në një vend ku njerëzit, në përgjithësi me pak dijeni për dialektin e vet, janë më pak të aftë të mësojnë ta shkruajnë dialektin fqinj. Jo! Zgjidhja më e mirë e problemit, ajo më praktike, do të ishte krijimi i një gramatike - të miratuar nga shqiptarët e shkolluar dhe nga albanologët - në të cilën të gjitha elementet dialektore, të grupuara, të pajtuara, të bashkërenditura, sipas një metode racionale e shkencore, do të lindnin një gjuhë të përbashkët për të gjithë shqiptarët, sikurse grekët që kanë Koïnë glôssa.



# PUSHTIMI I AFGANISTANIT

Lufta afgano-sovjetike zgjati mbi 9 vite. Ushtri i fundit rus u largua nga Afganistani më 15 shkurt të vitit 1989

## 38 VJETORI I GABIMIT VDEKJEPRURËS

Çereku i fundit i shekullit të 20-të dëshmoi dy zhvillime të rëndësishme, njëri 'Revolucioni Islamik' i zhvilluar në Iran dhe largimi i Shahut pas përmbysjes dhe tjetri pushtimi si sot 38 vite më parë i Afganistanit nga Bashkimi Sovjetik dhe tërheqja e tij duke u mposhtur si rezultat i rezistencës afgane, shkruan Anadolu Agency (AA). Të dy këto kanë patur efekte afatgjata si në nivel rajonal ashtu edhe atë ndërkombëtar. Në të vërtetë Afganistani në shekullin e 19-të kishte mbetur në mesin e aktorëve të "mëdhenj të lojës". Nga veriu, Rusia cariste po shkonte drejt jugut, ndërsa nga jugu britanikët po shkonin drejt veriut. Afganët ishin të detyruar të luftojnë kundër britanikëve për të mbrojtur pavarësinë e tyre dhe detyruan duke çuar në paqe superfuqitë e periudhës. Pas tërheqjes britanike nga nën-kontinenti indian në vitin 1947, kërcënimi në jug kishte mbaruar por kërcënimi në veri vazhdoi nga Bashkimi Sovjetik (1922-1991).

Fillimisht sovjetikët kishin marrëdhënie miqësore me Afganistanin. Ata kanë investuar në shumë fusha pas njohjes së pavarësisë së Afganistanit. Në vitet 1950, gjatë periudhës së kryeministrit të Serdar Davut, marrëdhëniet u bënë shumë të forta dhe investuan shumë në infrastrukturë. Aq shumë që edhe sot infrastruktura është ende në këmbë në shumë pjesë të Afganistanit. Me grushtin që Serdar Davut bëri në kohën kur ishte jashtë vendit mbreti Zahir Shah, sovjetikët filluan të afrohen me oficerët e pushtetit në Afganistan. Zamir Kabulov, përfaqësuesi special i Federatës Ruse në Afganistan, ka thënë se grushti i Davutit ishte gjithashtu një befasi për ta. Por, ai pranon se oficerët rreth tij ishin pro-sovjetikë. Më vonë, largimi i Davutit nga oficerët pro-rusë u konsiderua nga sovjetikët si "nisja e një loje të re ndërkombëtare". Me

fjalë të tjera, Davuti donte të ndryshonte kampin gjatë "Luftës së Ftohtë" dhe kjo kulturë sovjetike u pengua nga ushtria nga një grusht shteti ushtarak dhe Davuti u shkatërrua me gjithë familjen e tij. Por, problemi nuk mbaroi. Udhëheqësit afganë pro-sovjetikë ishin në konflikt gjithashtu mes tyre. Nur Muhammed Taraki dhe Hafizullah Emin, të cilët i bënë grushtin Davutit, humbën jetën e tyre në këto konflikte. Ndërsa Bashkimi Sovjetik e solli Babrak Karmalin në krye më 27 dhjetor 1979, dhe në fakt ishte fillimi 'de facto' i okupimit të Afganistanit.

### OBJEKTIVAT E PUSHTIMIT TË AFGANISTANIT

Arsyeja pse sovjetikët pushtuan Afganistanin u debatua shumë. Përgjigjja më e lehtë për problemin ishte qëllimi i rusëve për shekuj me radhë për të "dalë në ujërat e nxehta". Ne mund ta lexojmë këtë si një thyerje të rrethimit të SHBA-ve në Azinë Jugore. Megjithatë, në Afganistan, përkeqësimi i gjërave dhe zhvillimet gjeopolitike dhe strategjike që kanë ndodhur në rajon duhet të konsiderohen të kota në këtë pikë. Ndoshta rusët donin të merrnin

drejtimin në "lojën e madhe" dhe të merrnin hapa "parandalues".

Regjimi komunist që erdhi në pushtet në Afganistan pas grushtit të shtetit kundër Serdar Davut më 27 prill 1978, i njohur si "revolucioni Sevr", u përpoq të luante në një formë radikale me cilësi fetare dhe tradicionale të popullit. Kjo ishte e mjaftueshme për njerëzit që të ngriheshin. Kishte revolta në të gjithë vendin. Qeveria komuniste, e cila mori administrimin, filloi pastrimin brenda saj. Hafizullah Emin, likuidoi Taraki-n, ndërsa sovjetikët likuiduan Eminin, të cilën ata nuk kishin besim tek ai, dhe drejtpërdrejt me një grusht shteti ushtarak sollën në krye Babrak Karmal. Sipas Kabulov, Afganistani kishte arritur në një "pozitë shumë më të rëndësishme" nga pikëpamja strategjike për rusët pas grushtit të Mussadik. Për shkak të kësaj, sovjetikët investuan shumë për të fituar miqësinë e Afganistanit. Me ngritjen e popullit pas regjimit të Tarakit, të gjitha fitimet ishin duke humbur. Ndoshta kjo ka çuar që sovjetikët politikën e tyre për të mbajtur nën nënshtrim të lartë t'i kthenin në pushtim. Ndoshta udhëheqja sovjetike e asaj periudhe

besonte se "Ushtria e Kuqe", e cila përshkruhej si "e pamposhtur", do të vendoste në vijë shumë shpejt punët.

### REZISTENCA E POPULLIT AFGAN I PRISHI PLANET

Por, gjërat nuk shkuan ashtu siç pritej dhe shpresohet. Afganët që u ngritën kundër komunistëve lokalë nuk kanë qenë kurrë të kënaqur kur panë trupat e tyre të huaj në tokën e tyre. Afganët në rrugë nga jugu në veri dhe nga veriu në jug ishin mësuar me këtë situatë. Pavarësisht se sa të fuqishëm ishin pushtuesit dhe okupatorët, ata duke përhapur luftimet e tyre me kalimin e kohës dinin se si t'i dobësonin dhe t'i mposhtnin armiqët e tyre. Okupimi sovjetik e forcoi lidhjen e popullit dhe kryengritja rrethoi të gjithë vendin. Ndërkohë, një faktor tjetër shërbeu si katalizator. Shumë nga udhëheqësit e lëvizjes "Të rinjtë muslimanë", të cilët filluan luftën e tyre të re në universitete para grushtit të Serdar Davutit, u strehuan në Pakistanin e rifqinj pas grusht shtetit ku dhe Pakistani i cili bashkë me këta të rinj entuziastë kishte përfituar një instrument destabilizues për Afganistanin,

me të cilin herë herë ndodhej në prag të luftës për shkak të mos marrëveshjes territoriale. Madje, e përdori këtë instrument kundër Davutit, por ai dështoi.

Në periudhat vijuese, liderët si Hikmatjar, Rabbani, Mesut, Sayyaf dhe organizata si Shoqëria Islame, Hizbi Islam, ishin një mundësi e madhe për kryengritjet antikomuniste dhe anti-sovjetike në Afganistan për inteligjencën e Pakistanit ISI dhe më pas CIA-n. Në vend filluan të hynin armë të blera nga Kina me paratë, pjesa më e madhe e të cilave ishin të siguruar nga vendet e Gjirit. Pasi që nuk ishte e mundur të kontrollohej kufiri Afganistan-Pakistan, i cili ka një gjatësi prej 2.430 kilometrave dhe i cili njihet si Linja Durand, armët vazhduan të hyjnë në vend çdo vit e më të sofistikuar gjatë luftës sovjetiko-afgane. Madje, mund të thuhet se, po rridhnin aq shumë armë sa që u bë një sabotim në kampin ushtarak Uçri pranë kryeqytetit Islamabad, ku u ruajtën, depozituan armët që do të transportoheshin në Afganistan pasi ishte përcaktuar tashmë dalja e sovjetikëve dhe gjithashtu mijëra raketa u shpërthyen në kryeqytetin e Islamabadit, dhe në qytetin Revalpindi, të njohur si qytete binjake. Më shumë se qindra njerëz humbën jetën. Burimet zyrtare thanë se ishte një aksident, por raportet e hetimit nuk u zbuluan ndërsa një kryeministër u shkarkua nga detyra pasi tha që "unë do ti deklaroj".

### "USHTRIA E KUQE E PAMPOSHTUR" RA NË BALTË

Së bashku me luftën afgano-sovjetike, qarkulluan me kontribute të mëdha të mediave ndërkombëtare edhe konceptet "xhihad" dhe "muxhahidë". Këto ishin koncepte të popullit afgan, por ato u vendosën në qarkullim me qëllim që të krijonin vetëdijen në botën islame



kundër pushtimit "komunist". Pas përfundimit të pushtimit sovjetik këto koncepte u demonizuan sërish nga të njëjtat media ndërkombëtare. Për shkak se nuk mund të përcaktohej kohëzgjatja e pushtimit sovjetik dhe pasojat e tij, të rinjtë nga vendet muslimane, veçanërisht në vendet arabe dhe të Gjirit u inkurajuan që të shkojnë në luftë në Afganistan. Qindra, madje mijëra të rinj u bashkuan me xhihadin afgan. Disa nga këta të rinj u bënë "dëshmorë" në Afganistan. Disa prej tyre u kthyen në vendet e tyre pas përfundimit të luftës. Disa prej tyre janë drejtuar në zona të tjera të konfliktit. Ndërsa një pjesë e madhe e atyre që qëndruan në Afganistan, me shprehjen e njërit prej udhëheqësve kryesorë të Muxhahidinëve mbetet në bllokuar dhe u eliminuan gjatë likuidimit të talebanëve nga fuqitë veriore dhe të SHBA-ve.

Megjithatë qëndron edhe kjo se, këto kontribute në luftën afgane më vonë formuan bazën për krijimin e organizatave të tilla si Al-Kaeda dhe madje edhe DEASH, në shumë vende në botë. Është e dobishme të sqarohet një pikë këtu se grupet e njohura si "arabët afganë" u bashkuan me xhihadin afgan, por shfaqja e Al-Kaidës dhe organizatave të ngjashme është nga fundi i luftës. Ata madje organizimin e tyre e përfunduan pas tërheqjes sovjetike. Lufta afgano-sovjetike zgjati 9 vite e një muaj e gjysmë. Rusët brenda disa viteve e kuptuan se ishin zhytur në një baltë në Afganistan. Në vitin 1982 ata hynë në negociata indirekte me Muxhahidin përmes Kombeve të Bashkuara. "Ushtria e Kuqe e pamposhtur" pati një humbje shkatërruese në Malet Hindukush. Me ndërmjetësimin edhe të fuqive ndërkombëtare, sovjetikët filluan të tërhiqeshin nga Afganistani dhe ushtari i fundit rus u largua nga Afganistani më 15 shkurt të vitit 1989.

#### SHKATËRRIMI I MADHI SHKAKTUAR NGA LUFTA

Beteja e cila vazhdoi për nëntë vite e disa muaj ka pasur shkatërrim të tmerrshëm për të dyja palët. Sipas shifrave zyrtare të Bashkimit Sovjetik, Ushtria e Kuqe humbi 13.621 ushtarë në Afganistan. Pra, sipas shifrave zyrtare, vriteshin çdo ditë 4 ushtarë rusë. Ndërsa numri i ushtarëve të plagosur, të gjymtuar dhe të sëmurë në luftime ishte rreth 470 mijë. Në luftën dhjetëvjeçare 620 mijë ushtarë sovjetikë shkelën në Afganistan. Viktimat nuk mbetën të kufizuar vetëm me këtë. Përsëri sipas shifrave zyrtare, dëmet materiale në 451 helikopterë dhe avionë, 147 tanke, 443 topa e armë të tjera, i shkatërruan sovjetikët si nga ana ushtarake ashtu edhe në atë ekonomike. Miliarda dollarë barrë që solli lufta ishte një goditje e rëndë për sovjetikët. Ndërsa Bashkimi Sovjetik nuk mbijetoi shumë pas kësaj lufte. Si pasojë e kësaj pati humbje të jetës dhe pronës por më e rëndësishmja që humbi Bashkimi Sovjetik ishte prestigji dhe vlerat e dinjitetit. Ëndrra e tmerrshme e botës perëndimore kishte pësuar humbje, madje



**Beteja e cila vazhdoi për nëntë vite e disa muaj ka pasur shkatërrim të tmerrshëm për të dyja palët. Sipas shifrave zyrtare të Bashkimit Sovjetik, Ushtria e Kuqe humbi 13.621 ushtarë në Afganistan. Pra, sipas shifrave zyrtare, vriteshin çdo ditë 4 ushtarë rusë. Ndërsa numri i ushtarëve të plagosur, të gjymtuar dhe të sëmurë në luftime ishte rreth 470 mijë. Në luftën dhjetëvjeçare 620 mijë ushtarë sovjetikë shkelën në Afganistan**

një shpartallim të madh në Afganistan, një nga vendet më të prapambetura në botë sipas kritereve materiale. "Super Fuqia" u shndërrua në një luan prej kartoni në Afganistan. Muxhahidët kishin fituar luftën, por shkatërrimi në anën e tyre ishte shumë më i keq. Mbi një milion "dëshmorë", qindra mijëra gra të veja dhe jetimë. Një e treta e popullsisë së vendit emigroi. Infrastruktura u shkatërrua plotësisht dhe vendi, i cili tashmë është një nga vendet më të prapambetura në botë, është për-

ballur me një shkatërrim të madh. Më e rëndësishmja, ishte humbja e qetësisë dhe stabilitetit. Lufta e brendshme pas pushtimit sovjetik, shfaqja e talebanëve bashkë me pushtimin e Afganistanit nga një superfuqi tjetër, me pretekstin e Al-Kaedës dhe lëvizjet e 11 shtatorit, kjo paqe dhe stabilitet nuk erdhi kurrë më. Ka një debat të gjerë rreth asaj se si u fitua lufta në fuqinë e goditjes vdekjeprurëse të superfuqisë së periudhës në Afganistan.

Para së gjithash, janë vetëm njerëzit afganë që fituan luftën. Me jetën dhe gjakun e tyre, ata nënshkruan këtë fitore. Pothuajse një të 15-at e popullsisë së vendit kanë humbur jetën e tyre në luftë dhe një e treta ka rënë në situatën e një azilkërkuar jashtë vendit. Qindra mijëra janë të gjymtuar, qindra mijëra të tjerë janë gra të veja dhe jetimë. Edhe pse ndihmat materiale dhe ushtarake të Amerikës dhe mbështetësve të saj ndaj "Muxhahidëve" nuk mund të mohohen gjatë luftës, është një legjendë për të pohuar se lufta sovjetike është fituar me raketat tokë-ajër Stinger të dhëna nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kur SHBA filloi të jepte raketat anti-ajrore, lufta tashmë ishte fituar nga afganët. Dhënia e Stingerëve kishte për qëllim përkeqësimin e mëtejshëm të sovjetikëve dhe mbledhjen e përfitimeve të luftës. Nga ana tjetër, Ushtria e Kuqe duke patur në konsideratë faktorin Stinger, nisi ndryshime të rëndësishme në strategjinë e luftës, si bombardimi me avionë JET me raketa ajër tokë ajër

që shkonin jashtë distancës raktore si dhe me fluturime të ulëta me helikopterë. Lufta sovjetiko-afgane ka patur rezultate të rëndësishme dhe madje edhe ndryshuese të ciklit.

Beteja, e cila dukej si një luftë sovjetiko-afgane, por që në thelb ishte një luftë ideologjike islame-komuniste, e fitoi Islami pa injoruar mbështetjen e fortë të botës kapitaliste për Afganistanin kundër komunistëve. Kështu, në çerekun e fundit të shekullit të 20-të, të dy superfuqitë e "Luftës së Ftohtë" humbën përballë Islamit: Së pari humbi përballë muslimanëve në Iran përfaqësuesi kapitalist SHBA, dhe më pas në Afganistan përfaqësuesi i komunizmit Bashkimi Sovjetik. Islami erdhi në rendin e ditës si një ideologji alternative dhe botëkuptim në të gjithë botën. Megjithatë, mosmenaxhimi i procesit pasues dhe ardhja e islamit në agjendën e njeriut të botës si një mënyrë jetese alternative me manipulimet nga jashtë ka sjellë që kjo të qëndrojë si e tillë duke e përmendur bashkë me terrorizmin dhe duke sjellë bashkë me të edhe armiqësinë kundër islamit.

Në Afganistan u ngul gozhda e fundit në arkivolin e Bashkimit Sovjetik, që ishte një perandori moderne komuniste. Në 1922, Bashkimi Sovjetik, i cili mori vendin e Rusisë Cariste, u bë një nga dy superfuqitë e epokës së formuar pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte forca më e madhe ushtarake në botë, duke përfshirë armë bërthamore. Pas luftës afgane, blloku sovjetik u shemb dhe u shpërbë. Shumë vende nën sundimin e "Perandorisë Komuniste" fituan pavarësinë e tyre. Edhe republikat e Azisë Qendrore fituan pavarësinë e tyre. Më e rëndësishmja, u mbyll epoka e "Luftës së Ftohtë". Amerika ka mbetur e vetme si superfuqi.

#### DRAMA E POPULLIT AFGAN ENDE VAZHDON

Është ironike, por sovjetikët dhe afganët kanë luftuar dhe Amerika ka qenë ajo që ka dalë më fitimprurëse nga kjo. Aspekti më tragjik i luftës sovjetiko-afgane, e cila ka mbyllur dhe ka filluar një epokë, është se po-

**Vazhdon ende drama e popullit afgan, që bashkë me luftën sovjetike - ka humbur më shumë se një milion njerëz, ka humbur paqen dhe stabilitetin, gjallërinë dhe rendin. Pas tërheqjes së Bashkimit Sovjetik, vendi i cili u përfshi nga lufte e brendshme, e më pas i dominuar nga talebanët, iu nënshtrua ndërhyrjes së NATO-s nën udhëheqjen amerikane pas ngjarjeve të 11 shtatorit dhe që nga ky moment ka ardhur në situatën e fushëbetejës më të gjatë që ka vazhduar pa ndërprerë në historinë e SHBA-ve**

pulli afgan, i cili kundërshtoi fuqinë më të madhe ushtarake në botë në dem të jetës dhe gjakut të tyre dhe që e shkatërroi dhe e shpartalloi atë me mundësi primitive, nuk kanë përfituar kurrë pothuajse asgjë nga kjo luftë, përveç se ka pësuar humbje të mëdha.

Vazhdon ende drama e popullit afgan, që bashkë me luftën sovjetike - ka humbur më shumë se një milion njerëz, ka humbur paqen dhe stabilitetin, gjallërinë dhe rendin. Pas tërheqjes së Bashkimit Sovjetik, vendi i cili u përfshi nga lufte e brendshme, e më pas i dominuar nga talebanët, iu nënshtrua ndërhyrjes së NATO-s nën udhëheqjen amerikane pas ngjarjeve të 11 shtatorit dhe që nga ky moment ka ardhur në situatën e fushëbetejës më të gjatë që ka vazhduar pa ndërprerë në historinë e SHBA-ve, ku dhe gjithashtu nuk të jep përshtypjen se do të mbarojë në një kohë të shkurtër, madje bart shenjat e një lufte të re mandati. Rusët të cilët janë të shqetësuar nga Traktati i Sigurisë Dypalëshe të SHBA-Afganistan i cili përveç pranisë së SHBA-ve i jep të drejtën SHBA-ve për ndërtime 9-të bazave ushtarake, janë edhe një herë të interesuar për Afganistanin dhe madje duke mos patur nevojë për të fshehur nivelin e marrëdhënieve me talebanët. Ata i njohin talebanët si "një forcë lokale në masë të madhe që nga pika ku ata ndodhen sot". Sot është 27 dhjetor 2017, 38 vjetori i pushtimit sovjetik në Afganistan. Si sot vitin e kaluar, Zamir Kabulov, përfaqësuesi special i Federatës Ruse për Afganistanin në Moskë, dha një intervistë të gjatë për AA. I pyetur, "A ishte pushtimi i sovjetikëve në Afganistan një gabim?" Kabulov ishte përgjigjur "Po, ishte një vendim i gabuar, madje ishte gabim dy herë. Së pari, ne nuk duhet ta kishim bërë këtë, dhe së dyti, duhet të kishim dalë menjëherë pas hyrjes". Siç është e qartë edhe nga rezultatet, pushtimi sovjetik i Afganistanit ishte një gabim i madh, madje një gabim fatal. (Anadolu Agency)



Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës ose ndryshimet i sistemit zgjedhor në vend, por edhe të tjera, mbeten peng të pamundësisë së deritashme për ndryshime kushtetuese

Ndryshimet në Kushtetutën e Kosovës, të cilat konsiderohen të nevojshme për rrumbullakimin e proceseve të caktuara në vend, ndonëse në parim janë të mundura, ato ende mbesin praktikisht të pamundura për momentin, vlerësojnë ekspertët e çështjeve juridike kushtetuese dhe njohësit e zhvillimeve politike në vend. Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës ose ndryshimet i sistemit zgjedhor në vend, por edhe të tjera, mbeten peng të pamundësisë së deritashme për ndryshime kushtetuese. Profesori i të Drejtës Kushtetuese, Enver Hasani, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese, duke folur për Radion Evropa e Lirë, thotë se çdo ditë e më shumë po kuptohet ajo që është dashur të kuptohet që në fillim të pranimit të Planit Ahtisari, në mars të vitit 2007, si dhe miratimit të Kushtetutës së vendit në prillin e vitit që pasoi. "Kosova nuk është demokraci e shumicës, por demokraci kushtetuese parlamentare, ku pushteti buron nga populli, mirëpo ushtrimi i tij bëhet në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, mekanizmave kushtetues dhe ligjorë. Përveç kësaj, pushteti është i ndarë. Këto pushtete të ndara i nënshtrohen jo vullnetit të shumicës, por Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës. Pjesë e kësaj demokracie kushtetuese është edhe ajo pjesë e Kushtetutës dhe e Planit të Ahtisaarit, i cili është detyrim ndërkombëtar i Kosovës - të cilat cilësohen si pjesë të pandryshuesh-

# TË PAFUQISHËM PËRBALLË NDRYSHIMEVE KUSHTETUESE



me të Kushtetutës", thotë Hasani. Ai shton se jo vetëm Kosova, por edhe vende të tjera me demokraci të konsoliduar, si Gjermania, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe një pjesë e madhe e vendeve të demokracisë perëndimore, kanë dispozita kushtetuese sikurse që i ka Kosova dhe të cilat nuk mund të ndryshohen asnjëherë pa konsensus të gjerë nacional. Për ndryshimet kushtetuese, nevojiten dy të tretat e votave të tërësishme të Kuvendit të Kosovës, i cili ka 120 deputetë, si dhe dy të tretat e votave të komuniteteve pakicë. Njohësi i zhvillimeve parlamentare, Albert Krasniqi, analist nga Instituti Demokratik i Kosovës, thotë për Radion Evropa e Lirë se as në Kosovë e as në ndonjë vend tjetër, nuk është se gjithmonë të gjitha partitë kanë mendim të njëjtë për çështjet që kërkojnë ndryshime kushtetuese. Por, megjithatë, ai e sheh problemin te sigurimi i votave të komuniteteve pakicë, përkatësisht, të përfaqësuesve të komunitetit serb në Kuvendin e Kosovës, të cilët aktualisht i përfaqëson Lista Serbe. Sipas tij, kjo e fundit po mban peng ndryshimet kushtetuese për formimin e Ushtrisë

së Kosovës.

"Vota e tyre nuk ka ardhur kundër ose për të bllokuar ndryshimet kushtetuese për shkak të çështjeve të tyre parimore. Por, më shumë ka qenë ndjekja e agjendave të Beogradit në Kosovë dhe këtu është problemi. Nëse kjo, ashtu siç është e shkruar në letër, nuk do të përdorej vetëm për interesat e komunitetit serb që jeton në Kosovë, atëherë nuk do të kishte asnjë problem edhe pse është kjo dy të tretat, që është e dyfishtë, do të thotë, për komunitetet që mbajnë vendet e garantuara në Kuvend", thotë Krasniqi. Ndryshimet kushtetuese teorikisht janë të mundura, por në praktikë, tash për tash, mbeten të parealizuar. Sistemi zgjedhor, si kategori kushtetuese në Kosovë, gjithashtu mbetet peng i këtyre ndryshimeve, sikurse formimi i Ushtrisë së Kosovës. Profesor Hasani, shpreh mendimin se megjithatë, sistemi zgjedhor i Kosovës, si kategori kushtetuese, deri më tash ka luajtur rol mjaft pozitiv. "Sistemi zgjedhor është dispozitë e Planit të Ahtisaarit, që Kushtetuta e jonë vetëm e ka bartur në tekstin e vet. Ky sistem

zgjedhor, mendoj unë, ka luajtur rol shumë të madh dhe pozitiv në zhvillimin e demokracisë parlamentare në Kosovë, sado që kjo mund të duket paradoksale. Po të kishte qenë sistemi i përzier apo i shumicës, në Kosovë ka herë do të kishte pasur degjenerim të demokracisë dhe shkatërrim të diversitetit nacional, gjuhësor, fetar dhe kulturor etj. Unë e shoh këtë sistem zgjedhor si një aset të madh të Kosovës, sepse asnjëherë, asnjë force politike apo individ nuk i lejon komoditet dhe kjo ka shumë rëndësi të madhe për zhvillimin e demokracisë së re në Kosovë", vlerëson Hasani. Profesor Hasani shton se sistemi zgjedhor në Kosovë ka përbrenda vetes një mesazh, të cilin, siç ka thënë ai, politika në Kosovë nuk e ka kuptuar akoma: se për çështjet e interesit nacional duhet në fillim të krijohet me çdo kusht një konsensus i gjerë nacional dhe me atë konsensus të shtyhen përpara proceset që kanë rëndësi dhe peshë kushtetuese, e assesi asnjelltas. Sipas tij, Kushtetuta nuk mund të fajësohet e as të jetë zëvendësues për zgjidhjen e problemeve politike të Kosovës.



## Thaçi: Nisma për Specialen është alternativë

"Nisma e deputetëve për Gjykatën Speciale nuk është një kërkesë për të sfiduar gjykatën, por është alternativë, sikurse që kanë edhe vendet e tjera të ish-Jugosllavisë: Kroacia, Bosnja dhe Serbia", ka deklaruar në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Ai ka thënë po ashtu se nuk i inkurajojnë deputetët rreth kësaj nisme, por nëse Kuvendi e aprovon atë, do ta nënshkruante si president. "Unë ndihem shumë krenar që jam president i një vendi me orientimin dhe vullnetin më pro-amerikan në botë, më pro-evropian në Evropë dhe më pro-NATO, madje edhe prej vet vendeve anëtare të NATO-s. Prandaj, diçka e tillë as nuk ka ndodhur dhe as nuk do të ndodhë. Edhe iniciativa e rreth 50 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet të kuptohet si një alternativë dhe jo si një sfidim i drejtësisë, jo si injorim apo ikje nga drejtësia. Ata janë njerëzit e zgjedhur nga populli. I japin llogari zgjedhësve të vet dhe nuk i japin llogari as presidentit dhe as ndonjë mekanizmi tjetër institucional. Prandaj, Kosova vazhdon të punojë në rrugën e vet euroatlantike, për angazhimin e saj të sinqertë për t'u integruar në NATO, në Bashkimin Evropian dhe ruajtjen e përhershme të raporteve të veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Asnjë çmim nuk do ta lëkundë orientimin euroatlantik të Kosovës", është shprehur Thaçi.

## Varrosen eshtrat e vogëlushes gjashtëmuajshe e vranë nga serbët

Familja Qelaj shtatëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës ka varrosur eshtrat e vogëlushes së tyre, Dafinës, e cila ishte vranë nga forcat serbe në mars të vitit 1999. Në varrezat e dëshmorëve në Iz-

bicë janë varrosur eshtrat e vogëlushes Dafina Qelaj. Ajo ishte goditur në kokë nga forcat paramilitare serbe teksa ishte në gjirin e nënës së saj, dhe nga plaga e marrë ka ndërruar jetë një ditë më pas.



## Haradinaj takon zëvendësministrat, iu kërkon raporte të punës

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar takim pune me zëvendësministrat e Qeverisë. Në takim kryeministri Haradinaj ka kërkuar që secili nga zëvendësministrat të marrin detyrime dhe përgjegjësi të caktuara brenda dikastereve ku

janë të emëruar. Kryeministri Haradinaj ka kërkuar njëkohësisht nga zëvendësministrat që më 10 prill 2018, secili nga ta, të paraqesë një raport me shkrim për 100 ditëshin e dytë të qeverisjes, rreth punëve konkrete që janë bërë nëpër ministri me angazhimin e

drejtpërdrejt të tyre. "Qeveria e Kosovës është e përgjegjshme dhe transparente dhe ajo përmes raportit të pranuar të secilit zëvendësministër do ta njoftojë publikun detajisht për performancën e tyre", thuhet në kumtesën e Qeverisë.

# EKONOMIA GJERMANE

## OPTIMISTE

### PËR VITIN 2018



Më tepër se dy të tretat e shoqatave ekonomike të pyetura nga Instituti i Ekonomisë Gjermane presin prodhim më të lartë për sipërmarrjet e tyre. Edhe vetë ekspertët habiten për fuqinë e bumit ekonomik

"Pak i fërkoj me habi sytë si ekonomist", thotë i entuziazmuar drejtori i IW Michael Hüther për zhvillimin e vullshëm të ekonomisë, "pavarësisht se ku nis ta masësh periudhën e rritjes - në vitin 2011 pas krizës së rëndë apo 2013, pas një faze të shkurtër dobësie - kemi të bëjmë në çdo aspekt me një nga zhvillimet më të gjatë të rritjes, që kemi vëzhguar në konjunkturën gjermane, por edhe evropiane".

Studiuesi i ekonomisë tregon vërtet gjëra që të habitin: 26 nga 48 sipërmarrjet që pyesin rregullisht në fund të vitit punonjësit e institutit të tij flasin aktualisht për gjendje më të mirë ekonomike në krahasim me një vit më parë. 20 sipërmarrje e vlerësojnë gjendjen e tyre njësoj si të një viti më parë.

Por janë vetëm dy që raportojnë gjendje më të keqe - vitin e kaluar ishin nëntë sipërmarrje. Këto shifra pasqyrojnë një periudhë rritjeje ekonomike që po mban për një kohë të gjatë dhe - ajo që ndodh më rrallë - po zhvillohet thujse pa lëkundje. "Në prodhim dhe në punësim kemi një rritje si të hequr me vizore", thotë Hüther. Nga pikëpamja cilësore ky është një proces, i cili nuk ka të bëjë shumë me ciklet konjunkturorë të zakonshme, por që mbështetet në mundësitë e reja të zhvillimit. Një gjendje më e keqe ekonomike, sipas sondazhit aktual të Institutit të Ekonomisë vërehet vetëm në industrinë ushqimore dhe në Bankat Popullore e bankat Raiffeisen. Këto banka kryesisht të vogla, të organizuara si konsorciume

vuajnë veçanërisht në nivelin aktualisht të ulët të interesave bankare. Me fuzionime në njësi më të mëdha, disa institute përpiqen që t'i kundërvihen kësaj gjendjeje. Në dallim me këtë, një pjesë e madhe e degëve të industrisë si dhe të industrisë së pasurive të paluajtshme dhe të leasing-ut flasin për gjendje të mirë të biznesit. "Kemi kombinim të disa faktorëve pozitivë", shpjegon Hüther. Ekonomia botërore, e cila në kuadër të 24 muajve të fundit pati edhe dyshime, për shkak të problemeve në Azinë Lindore, nga diskutimi në SHBA, u tregua rezistente. Të ngjashme qenë zhvillimet edhe në Evropë. "Vendet e krizës ndodhen në një rritje të qartë dhe në të gjithë indikatorët ekonomikë në Eurozonë ndodhemi në atë nivel, siç ishte para

krizës së borxheve shtetërore". Me modelin e saj të biznesit, Gjermania u përshtatet shkëlqyeshëm nevojave të vendeve të tjera, tha Hüther. Kjo i shpjegon sukseset në eksport. Në një hap me këtë është edhe zhvillimi i gëzueshëm në tregun e punës me gjithnjë e më shumë persona të punësuar. Si rrjedhim, është "thujse e pashmangshme", thekson ekonomisti që gjendja të jetë e mirë edhe në ekonominë brenda vendit. Ana tjetër e medaljes: një e treta e sipërmarrjeve, të pyetura nga IW thonë se kapacitetet e tyre janë të mbingarkuara - dhe me këtë kërcënon një tejnxehje e ekonomisë. Si shkak për këtë, dy të tretat e sipërmarrjeve paraqesin mungesën e punonjësve të kualifikuar.



## Foshnja Kerim mund të humbasë edhe syrin tjetër

Foshnja jetime Kerim nga rajoni i rrethuar i Gutës Lindore në Siri, i cili gjatë një sulmi të regjimit të Bashar al Asadit humbi syrin e majtë dhe nënën e tij, mund të humbasë edhe syrin tjetër. Në një deklaratë për Anadolu Agency (AA), babai i Kerimit, Ebu Muhamed, tha se foshnja Kerim nuk po arrin të trajtohet mjaftueshëm për shkak të rrethimit të rajonit nga ana e regjimit, duke shtuar se ai përballet me rrezikun të humbasë edhe syrin e djathtë për shkak të goditjes në kokë gjatë sulmit dhe qelbit të tubuar në syrin e majtë. "Sipas mjekëve, i biri im mund të humb edhe syrin e djathtë nëse aty rrjedh qelbi i cili është tubuar në syrin e majtë që ka humbur. Edhe goditja që ka pësuar mund të shkaktojë humbjen e syrit tjetër", tha babai Muhamed, i cili shtoi se e kanë të pamundur të gjejnë barna. "Dua që i biri im të shërohet jashtë Gutës Lindore", theksoi Muhamed. Sipas tij, foshnja Kerim duhet të evakohet nga rajoni në mënyrë që të trajtohet dhe të shërohet në një spital me pajisje të plota. "Rrëfimi për Kerimin u shpërnda në çdo vend. Mori mbështetje të madhe nga bota. Falënderoj çdokënd që tregoi simpati për Kerimin. Mirëpo kjo nuk mjafton. Jo vetëm Kerimi, por qindrra fëmijë si ai në Gutën Lindore kanë nevojë për evakuim", theksoi Muhamed. Ai tha se mjekët kanë bërë çdo gjë, por se trajtimi i tij duhet kryer jashtë bllokadës, në mënyrë që Kerimi të mos humb edhe syrin tjetër. "Erdhën organizata humanitare. Thanë se do të na ndihmojnë, por nuk bëhet fjalë për ndihmë, sepse çfarë mund të bëjë me paratë kur nuk ka barna", tha ai. Ndryshe, foshnja Kerim është bërë simbol i rrethimit në Gutën Lindore në afërsi të Damaskut, i cili vazhdon që nga viti 2012. Kerim humbi syrin e majtë dhe nënën një muaj e gjysmë më parë nga një sulm me artileri nga forcat e regjimit.

## SHPËRTHIMI NË SHËN PETERSBUG ISHTE AKT TERRORIST

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka thënë se shpërthimi i djeshëm në një market në Shën Petersburg që la së paku 10 persona të lënduar, ka qenë një sulm terrorist. Një ditë pas sulmit, për të cilin autoritetet thanë se është bërë me një bombë të improvizuar, Putin foli ashpër duke thënë se forcat e sigurisë "duhet t'i likuidojnë" menjëherë terroristët e dyshuar nëse ata paraqesin kërcënim serioz. "E dini se dje në Shën Petersburg është kryer një sulm terrorist", ka thënë Putin gjatë një ceremonie për ndarjen e medaljeve për ushtarët që kanë marrë pjesë në operacionet ruse në Siri. Zëdhënësjja e një Komisioni për Hetime, Svetlana Petrenko, ka thënë të mërkurën se "bomba e bërë në shtëpi" ka shpërthyer me një fuqi të barasvlershme me 200 gramë të TNT-së [një material shpërthyes]. Por, forcat e rendit fil-



limisht kishin nisur hetimet për dyshime rreth një vrasjeje, duke sugjeruar se nuk dyshojnë për motive terroriste prapa shpërthimit. Rusia e quan fushatën e saj ushtarake në ndihmë të qeverisë siriane, si "veprim kundër terrorizmit", dhe Putin tha se ushtarët që kanë shërbyer në Siri kanë ndihmuar në shmangien e sulmeve potenciale, duke vrarë ekstremistët dhe duke i parandaluar

ata që të kthehen në Rusi. "Çfarë do të ndodhte nëse këta mijëra...kthehen në vendin tonë - kthehen të trajnuar, të armatosur dhe të përgatitur mirë?", ka thënë ai gjatë ceremonisë, duke iu referuar rusëve që kanë shkuar në Siri për të luftuar përkrah grupit militant, Shteti Islamik dhe grupeve të tjera terroriste. Zyrtarë rusë thanë të mërkurën se nëntë nga 10 të lën-

duarit nga shpërthimi janë dërguar në spital për trajtim mjekësor. Së paku një person ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore, ndërsa një tjetër është liruar nga spitali. Shpërthimi ndodhi pasi autoritetet e sigurisë thanë më 15 dhjetor, se kanë arrestuar shtatë persona të dyshuar si ekstremistë islamikë, të cilët po planifikonin sulme me bomba në një kishë dhe në vende të tjera në Shën Petersburg. FSB ka thënë se dyshohet që të arrestuarit janë anëtarë të grupit militant, Shteti Islamik dhe se ata po udhëzoheshin nga jashtë përmes mesazheve në aplikacionin Telegram. Pas arrestimeve, Putin kishte telefonuar Presidentin e Shteteve të Bashkara, Donald Trump, për ta falënderuar atë, për siç kanë thënë zyrtarë rusë, këshillën e CIA-së që ndihmoi për të parandaluar sulmet në Shën Petersburg.







DOKUMENTE EKSKLUZIVE

# QEVERIA E RSM-së PAS PUBLIKIMIT TË DEKLARATËS POLITIKE TË PDP-së

Në dokument, siç do të shohim në vazhdim, shprehej tërë mllefi antishqiptar i të ashtuquajturës "Qeveri eksperte", ku veç tjerash shqiptarët etiketoheshin me termin tepër irritues e ofendues "pakicë nacionale". Dokumenti, prej tre faqesh gjendet në Arkivin e Maqedonisë, fondi 159. I njëjti botohet për herë të parë dhe i plotë



Nga Qerim LITA

Të premtën e kaluar për lexuesit e gazetës shqiptare KOHA-Shkup, publikuam Deklaratën Politike të Kuvendit të Partisë Demokratike Popullore (në vazhdim PDP), botuar në gazetën maqedonase "Nova Makedonija" më 19 qershor të vitit 1991. Një javë më pas, përkatësisht më 27 qershor të atij viti, Ministria për Informim, e autorizuar nga Qeveria e RSM-së, lëshoi një komunikatë për mjetet e atëhershme të informimit, në të cilën veç tjerash atë e quan një "pamflet" nga ana e PDP-së, i cili çon, siç thuhet "kah destabilizimi i Republikës, kah cenimi i marrëdhënieve ndërnacionale...", krejt kjo "me qëllim të arritjes së funksionit të shkëputjes së pjesëve nga Maqedonia dhe krijimin e një fiksioni për Shqipëri të madhe". Në të siç do të shohim në vazhdim, shprehej tërë mllefi antishqiptar i të ashtuquajturës "Qeveri eksperte", ku veç tjerash shqiptarët etiketoheshin me termin tepër irritues e ofendues "pakicë nacionale". Dokumenti, prej tre faqesh gjendet në Arkivin e Maqedonisë, fondi 159. I njëjti botohet për herë të parë dhe i plotë.

\*\*\*

### KOMUNIKATË E MINISTRISË PËR INFORMIM TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË




"Me rastin e publikimit të Deklaratës Politike nga ana e Kuvendit të Partisë Demokratike Popullore (PDP) me seli në Tetovë në gazetën "Nova Makedonija" më 19 qershor të vitit 1991, Ministria për Informim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është e autorizuar të njoftoj për sa më poshtë vijon:

Deklarata Politike nga ana e Kuvendit të Partisë Demokratike Popullore përbën kulminacionin e vet të arogancës dhe sjelljes agresive të kësaj partie njënacionale, karakteristike për të thaujse në mënyrë konstante që nga vetë themelimi i saj. Ky pamflet politik në formë të deklaratës politike para-

qet legjitimimin e padiskutueshëm për qëllimet dhe përpjekjet e Partisë Demokratike Popullore të cilat janë të orientuar kah destabilizimi i Republikës, kah cenimi i marrëdhënieve ndërnacionale, getoizimin e pjesëtarëve të pakicës nacionale në Maqedoni, krejt kjo me qëllim të arritjes së funksionit të shkëputjes së pjesëve nga Maqedonia dhe krijimin e një fiksioni për "Shqipëri të madhe".

PDP që nga fillimi vë në dukje se në deklaratën e saj politike niset nga përcaktimet programore të partisë, edhe atë për shkak gjoja diskriminimit dhe mohimit e të drejtave nacionale të "kombit shqiptar në Jugosllavi", si dhe "për shkak armiqësive dhe jotolerancës katastrofale midis kombeve". Pranë kësaj, PDP-ë, pa as çfarë do lloj dyshimi niset përmes faktit se shqiptarët në vendin tonë, kuptohet edhe në Republikë, sipas asnjë dokumenti ndërkombëtar nuk mund të shpallen si komb, ndërsa si pakicë nacionale i gëzojnë të drejta shumë më të mëdha se sa cilado pakicë në Evropë – kanë shkollat, shtypin, programin e radios e të televizionit, teatro në gjuhën amtare dhe shumë të tjera. Si duket PDP-ë ka haruar se edhe vet ajo me përcaktimet e saja programore në përmasa të mëdha kontribuon për "armiqësitë dhe jotolerancën në mesin e kombeve", siç konstaton në deklaratën e saj politike.

PDP, padyshim se manipulon me të dhënat e saja të pasakta të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, duke pohuar se ai numër është mbi 3 milion shqiptarë, ndërsa motivi për manipulim të këtyllë është thënë në mënyrë të qartë e të padiskutueshëm në pikën 2 nga Delarata e përmendur, ku futet në funksion e të "drejtës për shkëputje nga robëria totalitare e asimiluese pansllaviste". Qeveria e Maqedonisë vlerëson se një qëndrim i til-



li i PDP-së deri më tash paraqet shprehje e paparë të tolerancës ndërnacionale dhe shovinizëm nga ana e ideologëve të PDP-së dhe hartuesve e të ashtuquajturës deklaratë politike të Kuvendit të kësaj partie. Kulmi i agresivitetit të PDP-së është angazhimi që: bartës i sovranitetit të Republikës së Maqedonisë të jetë kombi shqiptar që jeton në Maqedoni. Me një qëndrim të tillë PDP-ë prek në mënyrë më brutale në të drejtën historike për maqedonasit të cilët janë bartësit e sovranitetit të shtetit të tyre të vetëm nacional, Republika e Maqedonisë.

PDP, gjithashtu pa asçfarë ndjenjash të realitetit i mohon përfitimet të bashkëjetesës thaujse afër pesëshkullore pas luftës, kur edhe vetë pakica shqiptare në Maqedoni përjetoi rilindje të paparë në të gjitha fushat. Në mënyrë të veçantë është provokuese edhe parajlmërimi i PDP-së që mos t'i pranoj vendimet e "Samitit-Jugosllav" dhe kërkesën për zgjidhjen në "bashkimin mbarëkombëtar në një shtet të vetëm shqiptar në Ballkan". Kërkesa për "një shtet të vetëm shqiptar në Ballkan", është në kundërshtim me parimet e mosdryshimit të kufijve shtetëror në Evropë që e ka dokumenti përfundimtar i KEBS-it në Helsinki dhe është përpjekje retrograde në raport me proceset të lëshimeve dhe bashkëpunimit të kontinentit të vjetër, tërheqë vërejtjen Qeveria e Maqedonisë. Qeveria republikane në mënyrë më serioze vë në dukje për shkeljen e normave të veprimtarisë politike dhe sjelljes civilizuese nga ana e

kësaj Partie, të manifestuara në deklaratën e saj politike. Tezat e paraqitura në Deklaratën Politike të PDP-së publikohen për herë të dytë në opinion, ndërsa kjo për herë të parë qe bërë në gazetën "Flaka e Vëllazërimit" në fillim të këtij viti, por, si gabim shtypi. Në deklaratën e saj politike PDP-ë i përmend edhe "hegjemonistët maqedonas" të cilët "i diskriminojnë shqiptarët", pranë së cilës duke e heshtur në mënyrë të papërgjegjshme gjendjen faktike në Republikë e cila fare nuk korrespondon me pohimet e këtyllë të kësaj partie. PDP-ë e akuzon pushtetin maqedonas se është përcaktuar për "regresin" pa bërë përpjekje që edhe vetë ajo ta sheh se çfarë ka parashikuar Qeveria maqedonase, për shembull në Programin e saj për zhvillimin e Republikës në periudhën e mandatit rrjedhës.

Qeveria e Maqedonisë do t'u kundërvihet në mënyrë më të vendosur çdo lloj përpjekjeve për themelimin e një farë "parlamenti mbarëshqiptar, si bartës të platformës mbarëshqiptare në Jugosllavi", në territorin e Republikës, për çka angazhohet Partia Demokratike Popullore. Qeveria e Maqedonisë tërheqë vërejtjen se Partia Demokratike Popullore të shqiptarëve të Maqedonisë do të bartë përgjegjësi të plotë për shkak qëndrimeve të cilat i ka paraqitur në Deklaratën Politike të saj me çka përfolet për rrënimin e integritetit territorial të vendit e të Republikës së Maqedonisë, të cilat qëndrime nuk mund t'i kuptoj e t'i pranoj askush në botë sepse janë në kundërshtim me dokumentet e OSBE-së në Helsinki, të cilat dokumente prej para pak kohësh i nënshkroi dhe i pranoi, dhe njëkohësisht është e obliguar t'i respektoj edhe shteti i Shqipërisë. Për qëndrimet e PDP-së të paraqitura në Deklaratën Politike me çka aspirohet rrënimi i rregullimit e të traditave të cilat ndërtohen në Evropë, Qeveria e Maqedonisë do ta informoj Parlamentin Evropian, anëtarët e Bashkësisë Evropiane dhe opinionin më të gjerë evropian e botëror.

Shkup 27. 06.1991  
MINISTRIA PËR INFORMIM  
E QEVERISË SË REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË".

EDHE PSE PROBLEM MBETET PAGA E LARTË E LOJTARIT

# ABDURAHIMI SHUMË PRANË KALIMIT TE PARTIZANI



27-vjeçari bën pjesë në grupin e lojtarëve të mirë-paguar në klubin tetovar, ku në varësi të paraqitjes së tij, ku përfshihet edhe bonuset, rroga e tij shkon nga 10-15 mijë euro në muaj. Por nëse Partizani arrin t'i ofrojë të njëjtën rrogë që përfiton te Shkëndija, Abdurahimi do të vishej i kuq pa problem

Shkup, 27 dhjetor - Besart Abdurahimi është një nga piketat e Partizanit për merkaton e dimrit bën të ditur gazeta "Panorama-sport". Sulmuesi i Shkëndijës së Tetovës shikohet si një përforcim i rëndësishëm për të kuqtë, për vetë kualitetin që mbart 27-vjeçari, i cili ka qenë edhe pjesë e Përfaqësueses së Maqedonisë. Abdurahimi ka një karrierë të pasur, por këtë sezon nuk ka gjetur hapësirë e duhur te Shkëndija, pasi konkurrenca te kuqezinjtë është e madhe në rolin ku ai luan. Abdurahimi do të ishte një alternativë për krahun e djathtë të sulmit të Partizanit, rol të cilin prej



javësh e ka kryer Jasir Asani. Burime të ndryshme pranë lojtarit kanë bërë me dije se Abdurahimin e pëlqen mundësinë që të transfe-

rohet te Partizani, por ai nuk kërkon të nxitohet, për vetë kushtet financiare që ka te Shkëndija. 27-vjeçari bën pjesë në grupin e

lojtarëve të mirë-paguar në klubin tetovar, ku në varësi të paraqitjes së tij, ku përfshihet edhe bonuset, rroga e tij shkon nga 10-15 mijë euro në muaj. Por nëse Partizani arrin t'i ofrojë të njëjtën rrogë që përfiton te Shkëndija, Abdurahimi do të vishej i kuq pa problem. Duke pasur kontratë deri në fund të sezonit me kryesuesit e kampionatit maqedonas, Abdurahimi pritet që të mos heqë dorë nga përfitimi financiar. Për momentin, distancën mes Partizanit dhe Besart Abdurahimit e bënë rroga e lartë që lojtari përfiton te Shkëndija e Tetovës.

## Dy klube të mëdha pas Hysajt

Elseid Hysaj u kritikua ashpër për paraqitjen në ndeshjen e fundit ndaj Sampdorias ku shkaktoi penallti. Edhe pse në fund Napoli fitoi 3-3, shqiptari u kritikua ashpër në rrjete sociale, madje edhe u fye nga tifozët e ekipit. Mirëpo, janë dy klube të mëdha evropiane që kanë rikthyer interesimin për Hysajn, raportojnë mediat italiane. Bayern Muni dhe Liverpool dëshirojnë mbrojtësin e djathtë në radhët e tyre. Pengesë mbetet klauzola e lartë për shkëputjen e kontratës, plot 50 milionë euro. Sidoqoftë, një lëvizje duket e pamundur në afatin e janarit, pasi Napoli zë vendin e parë në Serie A, me shpresën se do të fitojë titullin e kampionit pas 27 vitesh.



## E ardhmja e Lenës në Durrës në dyshim

Skuadra e Teutës bëri revolucion në verë dhe duket se edhe në janar do të ketë disa lëvizje. Me emërimin e Nicës në bankinë pritet të marrin përgjigje, kryesisht ato që lidhen me merkaton. Këto ditë janë lakuar disa pista, në hyrje dhe në dalje. Nazmi Gripshi me shumë mundësi do të rikthehet në Durrës, ku edhe spikati para se ta blinte Skënderbeu. Por shqetëson fakti që emra të rëndësishëm të formacionit mund të largohen, duke nisur me kapiteinin Nijas Lena. Mesfushori strugan i rikthyer në verë nga Kukësi është kritikuar disa herë, ndërkohë që "Supersport" raporton se e ardhmja e tij në Durrës është në dyshim. Cekim, gjatë karrierës së deritanishme Lena ka luajtur për Renovën, Makedonija Gj.P., Milanon, Flamurtarin, Kukësin dhe së fundmi Tetutën.



Sulmuesi i përfaqësueses së Zvicrës, Admir Mehmedi, nga ja-

## Malatiasporti pas Mehmedit

nari i vitit të ardhshëm mund të luajë në kampionatin e Turqisë. Interesim për sulmuesin e ekipit gjerman Bajer Leverkusen ka shprehur Malatiaspori. "Admir Mehmedi dhe Ahmed Hassan janë dy lojtarët që Malatiaspor synon t'i transferojë gjatë janarit. Për Mehmedin opsjon është huazimi me mundësi blerje", shkruan "futbolarena.com". Ndryshe, Malatiaspor zë vendin e dhjetë

në Superligën turke me 22 pikë. 26-vjeçar nga Gostivari në dhjetë paraqitje të këtij sezoni në Bundesliga 1 të Gjermanisë ka shënuar dy gola dhe ka kontribuar me tri asistime në dhjetë ndeshje. Me ekipin gjerman ka kontratë deri në verën e vitit 2019. Interesim për Mehmedin ka shprehur edhe skuadra tjetër gjermane, Hamburg.

## Përfundon "dashuria" mes Mbellas dhe Shkupit

Shkup, 27 dhjetor - Skuadra e FC Shkupi edhe pse tani më është në pushim të merituar, kryesia e klubit ka filluar të bëjë edhe planet për përforcimet eventuale në klub.

Para se gjithash në një takim të futbollistëve me stafin e trajnerëve dhe kryesisht, është arritur marrëveshje që të gjithë fut-

bollistët do të mbeten në skuadër edhe për gjysmë sezonit e ardhshëm. Derisa nga klubi bardhekaltër njoftuan se i vetmi lojtar që do të largohet nga skuadra bardhe kaltër, është sulmuesi francez Emmanuel Mbella.

"Me marrëveshje mes dy palëve është shkëputur kontrata me Mbellan. Kryesia e klubit

falënderon atë për kontributin e dhënë gjatë qëndrimit të tij një vjeçar në skuadër, duke i uruar suksese në karrierë", thonë nga klubi bardhekaltër.

Jo zyrtarisht flitet se për shërbimet e Mbellas janë interesuar disa klube, në mesin e të cilëve Kukësi, Partizani, Tirana, Llapi e Gjilani.



## Bardhi ëndërron Ligën e Kampionëve

Enis Bardhi, synon të luajë një ditë me ndonjë skuadër në Ligën e Kampionëve. 22-vjeçari është duke treguar paraqitje të mira me Levanten në La Liga të Spanjës. Ka shënuar katër gola në 15 paraqitje këtë edicion, që është i pari për të në Spanjë. "Ëndërra ime është që një ditë të luaj në Ligën e Kampionëve. Unë do të luaj çdo ndeshje duke dhënë maksimumin tim. Goli im i parë në La Liga ishte i veçantë për mua. Jam ndjerë shumë mirë që nga dita e parë që

kam arritur në Spanjë. Kam gjetur mbështetje maksimale", ka thënë Bardhi në një intervistë për "La Liga". Ndryshe, Levante është në pozitën e 16-të me 18 pikë, ndërsa synim ka mbijetesën. Te Levante mesfushori ofensivë u transferua në verën e këtij viti nga skuadra hungareze Ujpest. Me ekipin spanjoll ka kontratë deri në vitin 2020. "Edhe në Hungari kam pasur një përvojë pozitive. Shpresoj që gjithë karriera ime të ketë këtë ritëm", ka përfunduar Bardhi.







## Transferim i Pastores te Interi varet nga PSZH-ja



Drejtori i Inter Piero Ausilio ka lënë të kuptohet se Interi do të bëjë një ofertë për Pastoren gjatë janarit. "Nuk besoj se dikush ka dyshime mbi kualitetin e tij. Duhet të kuptojmë se çfarë do të bëjë PSZH. Ai është një lojtar i rëndësishëm, jemi të lumtur që e shoh Interin si një mundësi, por është e parakohshme të flasim për këto gjëra. I di limitet financiarë. Nuk jemi të interesuar të blejmë dikë vetëm për hir të merkatos. Duhet të mbajmë grupin e tanishëm. Por duhet të jemi të gatshëm për çdo mundësi që do të na paraqitet", u shpreh Ausilio. Ai thotë se Interi nuk është në krizë dhe se trajneri Luciano Spalletti ka besim tek lojtarët. "Interi nuk është në krizë, mendoj se është e natyrshme të humbasësh disa ndeshje pas disa muajsh. Mendoj se ishin ndeshje të pazakonta dhe biseditmet për një krizë janë të egzageruar. Spalletti dhe klubi kanë besim të madh të djemtë. Skuadra mund të përmirësohet, të gjithë mundet. Do të punojmë për merkaton, pasi e konsiderojmë veten tonë një skuadër e fortë, por jo perfekt", deklaroi Ausilio, drejtori i Interit.

# MILANI KA GATI ZËVENDËSUESIN E DONNARUMMAS



Për shkak të situatës së keqe të krijuar rreth tij, Donnarumma mund të largohet nga klubi që në janar, gjithmonë nëse do të vijë oferta të rëndësishme nga klubet e tjerë. Siç ka ndodhur edhe në verë, kur Gigio ka refuzuar rinovimin, Milan është vënë në lëvizje për të gjetur një zëvendësues

Me afrimin e merkatos së dimrit shtohen gjithnjë dhe më shumë zërat për të ardhmen e Gianluigji Donnarummas. Portieri i Milanit, që në ditët e kaluara ka qenë në qendrën e polemikave të krijuara mes Mino Raiola dhe Massimiliano Mirabelli, ka rritur zemërimin dhe dyshimet e tifozëve kuqezij pas tërheqjes nga derbi i Kupës së Italisë. Ai që dukej një dëmtim i lehtë është kthyer në një problem serioz që e ka penguar lojtarin të luajë në atë që do të kishte qenë ndeshja e tij numër 100 më "Djallin".

Kështu, për shkak të situatës së keqe të krijuar rreth tij, Donnarumma mund të largohet nga klubi që në janar, gjithmonë nëse do të vijë oferta të rëndësishme nga klubet e tjerë. Siç ka ndodhur edhe në verë, kur Gigio ka refuzuar rinovimin, Milan është vënë në lëvizje për të gjetur një zëvendësues. Pepe Reina është emri në krye të listës për sezonin e ardhshëm, por nëse largimi i Donnarumma do të ndodhë në janar, Fassone dhe Mirabelli do të jenë të detyruar të gjejnë një zgjidhje të përkohshme. Një nga këto mund të jetë Federiko Marketi, portieri 34-vjeçar i Lacios, i cili është jashtë skuadrës bardhekaltër për momentin. Ai ka humbur vendin e titullarit pas një dëmtimi të pësuar pikërisht në një ndeshje të luajtur kundër kuqezinjve shkurtin e kaluar dhe është një nga objektivat e vjetër të Milanit, që ka kërkuar ta marrë edhe vitin e kaluar para shitjes së klubit te kinezët.

shumë mirë Vidal, të cilin e ka pasur te Sevija nga ku u transferua në "Camp Nou". Monçi e ka kërkuar futbollistin në formën e huazimit, me të drejtë blerje në fund të sezonit. Barcelona duket e gatshme ta pranojë ofertë, duke qenë se Vidal nuk ka gjetur hapësirë, që kur firmosi për skuadrën "blaugrana" në verën e vitit 2015. Roma duhet të bëjë kujdes nga konkurrenca e Atletico Madrid, që ka kërkuar zyrtarisht futbollistin. Atletico kërkon Vidal për të zëvendësuar Huanfran dhe Vrsaljko, për të cilët është vendosur se do të largohen në fund të sezonit. Gjithsesi, miqësia e tij e vjetër me Monçi i jep shpresë Romës dhe mund të rezultojë vendimtare në arrijtjen e marrëveshjes, që në janar.

## Sirena të reja kineze për Mandzukiçin

Në merkaton e dimrit të kaluar, duke vënë "në pjatë" 28 milionë euro për kartonin e tij dhe një kontratë 4-vjeçare prej 8 milionësh neto në sezon, kroatin e Juventusit e kishte tentuar klubi kinez i Tianjin. Tani, përsëri, nga i njëjti vend, Hebei China Fortune po teston terrenin. Objekti i dëshirës mbetet i njëjtë: Mario Manxhukiç. Sulmuesi 31-vjeçar i Juventusit, i lidhur me bardhezinjtë deri në vitin 2020, i ngroh mendimet e Superligës Kineze. Ka klube atje, që nuk kursejnë asnjë shpenzim, teksa kanë siguruar lojtarë dhe trajnerë të nivelit më të lartë. Pasi e ka mbyllur kampionatin me vendin e katërt, në qytetin e Quinhuangado është koha për të menduar për goditje të reja. Idetë nuk mungojnë. Paratë jo. Pra, klubi kinez në fjalë është duke ndjekur më të mirën e merkatos evropiane. Dhe lind sugjerimi "Manxhukiç". Disa ndërmjetës të lidhur me futbollin kinez, në mënyrë kretësisht embrionale, do të mundoheshin të provonin gjendjen shpirtërore të sulmuesit kroat. Paraja, veçanërisht në këtë periudhë historike, për një profesionist mund të nënkuptojë gjithçka. Por bomberit i Juventusit, edhe pse i kënaqur nga këto sirene të reja, do të preferonte të qëndronte në futbollin italian. Përgjigjja, pra, do të kufizohej në një "Jo, faleminderit" e qartë. Në të njëjtën kohë, në mes të sezonit, "Zonjës së Vjetër" historikisht nuk i pëlqen ta privojë veten nga pjesët më të mira të saj. Aq më shumë nëse ato kanë karakteristika unike. Pjesa tjetër është një çështje nderimi mes Max Allegrit dhe numrit të tij 17, bazuar në një marrëdhënie të fortë dhe produktive. Trajneri i Livornos ka respekt të madh për 31-vjeçarin dhe, për këtë arsye, Super Mario e konsideron Kinën shumë larg...



## ROMA VAZHDON TA NDJEK VIDALIN

Kthehet emri i Aleiks Vidal për Romën, që vazhdon të ndjek me shumë kujdes mbrojtësin spanjoll, i cili është gjithashtu në planet e Atletico Madrid. Barcelona nuk ka besuar kurrë te futbollisti i rritur te Sevija, i cili ka përfunduar zgjedhja e tretë e trajnerit Ernesto Valverde për krahun e djathtë të mbrojtjes, pasi Sergjo Roberto dhe Semedo. Kjo është arsyeja përse aventura e tij në Katalonjë mund të mbyllet në janar, me verdhekuqtë të gatshëm për ta shpënë në kryeqytetin e Italisë. Marrëveshja mes Roma dhe Barcelona mund të favorizohet nga prania e drejtorit sportiv Monçi, i cili e njeh

shumë mirë Vidal, të cilin e ka pasur te Sevija nga ku u transferua në "Camp Nou". Monçi e ka kërkuar futbollistin në formën e huazimit, me të drejtë blerje në fund të sezonit. Barcelona duket e gatshme ta pranojë ofertë, duke qenë se Vidal nuk ka gjetur hapësirë, që kur firmosi për skuadrën "blaugrana" në verën e vitit 2015. Roma duhet të bëjë kujdes nga konkurrenca e Atletico Madrid, që ka kërkuar zyrtarisht futbollistin. Atletico kërkon Vidal për të zëvendësuar Huanfran dhe Vrsaljko, për të cilët është vendosur se do të largohen në fund të sezonit. Gjithsesi, miqësia e tij e vjetër me Monçi i jep shpresë Romës dhe mund të rezultojë vendimtare në arrijtjen e marrëveshjes, që në janar.






1. Virgil van Dijk,  
85 milionë euro

Liverpul ka thyer rekordin pas 85 milionë eurove të paguara për të marrë Virgil van Dijk nga Sauteamptoni.




2. Benjamin Mendi,  
57 milionë euro

Guardiola, i pangopur. Pas Ualker, në verën e 2017-ës, ka siguruar edhe ish-lojtarin e Monakos për 60 milionë euro.



3. Xhon Stones,  
55 milionë euro

Premier Liga dhe Siti, gjithmonë protagonistë: Stones ka kushtuar plot 55 milionë euro në verën e 2016-ës.



4. Kyle Ualker,  
51 milionë euro


Mendi, Danilo, Ederson dhe jo vetëm: në verën e 2017-ës Siti ka marrë edhe Kyle Ualker, për 51 milionë euro.



5. David Luiz,  
50 milionë euro

Çells, PSZH dhe përsëri Çells. Qendërmbrojtësi braziliani është blerë nga francezët për 50 milionë euro, por është paraqitur më mirë i zhvendosur disa metra më përpara.

# 10 MBROJTËSIT MË TË SHTRËNJTË TË HISTORISË SË FUTBOLLIT



6. Rio Ferdinand,  
46 milionë euro

Rekordi i Rio Ferdinand ka rezistuar 12 vite dhe deri në 2014-ën ka qenë mbrojtësi më i shtrenjtë i historisë (nga Lids te Mançester Junajted).



7. Nikolas Otamendi,  
44 milionë euro

Nuk është as Nesta dhe as Turam, por për Sitin i vllente të gjithë 45 milionë eurot e derdhura në arkat e Valencias.




8. Leonardo Bonuçi,  
42 milionë euro

Transferimi më i diskutuar i merkaton së verës së kaluar: Bonuçi ka kaluar nga Juventusit te Milani për të zhvendosur ekuilibrat.



9. Tiago Silva,  
42 milionë euro

Fillimi i ciklit të PSZH-së milioner: Tiago Silva ka kaluar nga Milano në Paris për 42 milionë euro në verën e 2012-ës.



10. Lilian Turam,  
41 milionë euro

Një nga transferimet më të shtrenjta të historisë së Juventusit, për një nga qendërmbrojtësit më të mëdhenj të historisë. Më pak fjalë, para të shpenzuara mirë për Turam.

Virgil van Dijk, i blerë nga Liverpooli, është bërë mbrojtësi më i shtrenjtë i historisë së futbollit. Ai ka arritur të thyjë disa rekorde që mendohej, në kohën kur u vendosën, se nuk do të thyeshin kurrë

Pas një telenovele që ka zgjatur më shumë se gjashtë muaj, Virgil van Dijk më në fund është blerja më e re e Liverpoolit. Të Kuptë e Jurgen Klop kanë paguar plot 84 milionë euro për

qendërmbrojtësin e Sauteamptoni, i cili është bërë kështu mbrojtësi më i shtrenjtë i historisë.

Nuk ka vonuar edhe konfirmimi i lojtarit, i cili ka zgjedhur "In-

stagram" për të pozuar me fanelën e re duke thënë edhe disa fjalë mbi aventurën e tij të re. "Jam i lumtur dhe krenar që kam arritur marrëveshjen me FC Liverpool. Sot është një ditë e veçantë

për mua dhe familjen time teksa i bashkohem një prej klubeve më të mëdha të botës së futbollit. Me zi po pres të vesh fanellën e famshme të Kuqe për të parën herë përpara tifozëve të zjarrtë dhe do

të jap gjithçka për të arritur gjëra të mëdha në vitet në vazhdim", deklaroi Van Dijk. Ndërkohë, në vazhdim do të shihni se kush janë 10 mbrojtësit më të shtrenjtë të të gjitha kohërave.

## INTERI NË KRIZË, IKARDI E PERISHIÇ NË VËSHTIRËSI

Nëse ende mungonte konfirmimi përfundimtar, kjo është shumë e vërtetë pas humbjes në derbi dhe eliminimit nga Kupa e Italisë: Interi është zhytur zyrtarisht në krizë. Kjo bëhet më e shpjgueshme, kur merret parasysh se deri në gati tri javë më parë, kjo skuadër ishte e vetme në krye të renditjes së Seria A. Një rënie kryesisht psikologjike, që përkoi me humbjen kundër Udinezes, por edhe me bllokimin e performesve më të mirë, Mauro Ikardi dhe Ivan Perishiç, të cilët ishin autorët e 24 golave nga 34 të tillë në



total, të realizuar deri më tani nga zikaltrit. Produktiviteti ofensivë,

shumë i kushtëzuar, ishte prekur javë pas javë. Në tri ndeshjet e

fundit kjo qasje ka humbur (katër ndeshje, në qoftë se në to përfshijë barazimin 0-0 kundër Pordenone), sepse është shënuar vetëm një gol kundër Udinezes. Edhe kundër Milanit është bërë vetëm një goditje në pjesën e parë (më keq kishte ndodhur vetëm kundër Juventusit, me zero goditje), ndërsa gjuajtja e parë në portën e mbrojtur nga Donnarumma mbërriti pas një ore lojë. Një tjetër e dhënë shumë negative është goditja e Zhoao Mario: apatik dhe aspak i mprehtë, ai shpërdoroi një mundësi të artë,

duke mos e mposhtur dot Donnarumma nga një distancë e afërt dhe duke nxitur zemërimin e tifozëve, të cilët menduan se do të shijonin golin e parë.

Spaleti ka lënë të kuptohet tashmë se i shërben sa më shpejt të jetë e mundur ndryshimi i kursit, për të shmangur zhgënjimin në kampionat. Me këtë zakon të keq, katër vendet e para, që janë me vlerë kualifikimi për në Ligën e Kampionëve, mund të bëhen një fantazi. Dhe në atë rast dështimi do të kthehej si trishtimi në modë.

Koha, e premte 29 dhjetor, 2017



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Do merrni bekimin e yjeve gjatë kësaj dite dhe marrëdhënia me partnerin/en do jetë e shkëlqyer. Emocionet që do përjetoni do jenë të papërshtueshme. Për beqarët do jetë ditë e animuar dhe e këndshme. Shfrytëzoheni edhe pse jo të gjithë do e gjejnë shpirtin e tyre binjak. Në planin financiar duhet të vepronin me shumë kujdes.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Asgjë e veçantë nuk pritet të ndodhë sot në jetën tuaj në çift. Merrni gjërat si t'iu vijnë dhe bëni atë që ndjeni për momentin. Beqarët do kenë takime pa fund, por prej tyre mund të lindin vetëm histori dashurie pa të ardhme. Plutoni do ju bëjë më të kthjellët në planin financiar dhe do dini mirë sa të shpenzoni.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Klima në jetën tuaj në çift do fillojë të ngrohet sot. Do i kërkonti falje partnerit/es për gabimet që keni bërë dhe ai do iu kuptojë. Venusi do i nxitë beqarët të kërkojnë vetëm aventura kalimtare. Mundësitë do jenë të shumta në fakt, por edhe mund të lëndoheni. Financat do jenë në gjendje shumë të mirë.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Do bëni mirë të mos ëndërroni më shumë sesa duhet sot në planin sentimental sepse realiteti do iu zhgënjëjë pa masë. Beqarët do jenë sharmantë dhe do kenë më shumë mundësi për ta gjetur personin e duhur. Sektori i financave do jetë goxha i stabilizuar.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Mjedisi yjor do ju ndihmojë ta përmirësoni shpejt jetën tuaj në çift sot. Në mbrëmje do kaloni momente të paharruara të cilat i keni parë vetëm nëpër filma. Beqarët do takohen me miq të vjetër në këtë periudhë festive dhe nuk do e ndiejnë mungesën e një partneri/e. Në planin financiar gjërat do vijnë duke u përmirësuar.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Do jeni shumë të drejtpërdrejtë me partnerin/en tuaj sot dhe do flisni me të për gjithçka që ju shqetëson. Edhe po e ngritët paksa zërin në ndonjë moment ai do iu kuptojë. Beqarët do bëjnë mirë të mos iu besojnë të gjithë personave që do i joshin sepse do lëndohen. Në planin financiar qëndroni gjithë kohës vigjilentë.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Çiftet ka rrezik të kalojnë një krizë të vështirë sot. Nuk do bini dakord për asgjë me partnerin/en dhe situata mund t'iu dalë shpesh jashtë kontrollit. Kujdes! Beqarët do afrohen shumë me personin që pëlqejnë dhe mund të nisin një lidhje. Financat do jenë delikate.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Do pajtoheni me partnerin/en tuaj sot dhe një tjetër etapë do fillojë për jetën tuaj. Nuk do i mbani më të fshehta, por për gjithçka do flisni hapur. Beqarët nuk do e kenë mendjen tek krijimi i një lidhjeje, por një takim impresionues do i bëjë të ndryshojnë rrjedhën e jetës. Financat do vazhdojnë të jenë të ekuilibruara.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Falë ndikimit pozitiv të Diellit do filloni të tregoheni më të hapur me partnerin/en tuaj dhe do ja shprehni atij gjithçka që do ndjeni. Edhe ai nga ana tjetër do ju kushtojë më tepër kohë dhe vëmendje. Beqarët nuk do kenë takimet që kanë pritur kështu që do qëndrojnë vetëm. Në planin financiar nuk duhet bërë shaka me shpenzimet.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Sot jeta tuaj në çift do fillojë pak nga pak të stabilizohet. Do jeni me të përgjegjshëm për ato që do thoni dhe nuk do nxitoheni të merrni vendime. Për beqarët priten takime interesante. Financat nuk do jenë në gjendje më të mirë të mundshme, por jo dhe shumë të këqija. Shpenzoni me maturi.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Çdo gjë do shkojë më së miri sot në jetën tuaj në çift, madje atmosfera do mbetet gjithmonë harmonike. Do e kuptoni njëherë e përgjithmonë se partneri/ja i tanishëm është ideali për të kaluar gjithë jetën. Beqarët duhet të shmangnin personat e shenjës së Akrepit dhe Bricjapit. Në planin financiar situata mund të përkeqësohet për shkak të lojërave të fatit.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Do e shijoni në maksimum sot kohën që do kaloni me partnerin/en tuaj dhe marrëdhënia në çift do jetë e mrekullueshme. Nuk do keni me çfarë të kërkonti më tepër. Beqarët nuk do kenë fat në dashuri dhe sërish do ngelen vetëm. Në planin financiar priten përmirësime të vogla të situatës.

*mesatar*

4				6			5	
			2					7
7		6	4				9	
			1		9	5	3	
3								1
	4	9	6		5			
	7				6	3		
2					3			
	1			2		8		9


**PËRKUJTIM**



**AZEM REXHEPI**

Me shumë dhimbje, mall dhe krenari do të kujtojmë përgjithmonë!

Me mall të kujtojmë Ruhan Limani dhe Nimetulla Bilalli



Mensur Mamuti	PAGESA NË DORË	KLUBI AKTUAL I TRAJNERIT NË FOTO	0	EMRI I VJETËR I BRITANISË SE MADHE	
KËSHTJELLË		KOCKË (LAT) *... IACTA EST			
FUTBOLLISTI YNË, ABDULLA					
<b>XH</b>					
RRENOJ, PRISH					
<b>KOHA</b>	APPLICATION PROGRAMMING INTERFACE				
	KOMPANI JAPONEZE				
JODI		HËNË E JUPITERIT			
PJESA E SIPËRME E DHOMËS		KLUBI I PARË I FUTBOLLISTIT NË FOTO			
<b>T</b>					
ONOMATOPE PËR 'NUKTHASNJË FJALË', GËK				TINGULLI MË TË CILIN FILLON NË FJALË A NË RROKJE	
KRIMB, KARREM					
<b>KOHA</b>	SHPORTË	KENGETARJA JONË GJATA	RAFT SKEDASH	KOMPOZITORI ITALIAN, XHOVANI	DYQAN ONDULIMI
					ITRIUMI
ISH FUTB. I KOMBËTARES DHE TRAJNERI NË FOTO					
UJDHESA - ISH BURG NË SAN FRANCISCO					
					SQUFURI DHOMA
MENAXHERI SUEDEZ, ERRIKSON					AUSTRIA URUGUAI
					SPORT NË UJË KETE DITE
GJYKATËS NË PERANDORINË OSMANE					SIDOQOFTË GALIUMI
REGJISORI TORO					
<b>Q</b>					MAGAR KALIUMI
SEKT I VEÇANTË FËTAR I MUSLIMANËVE					
					ENERGJIA

ZGJIDHJET: O, KALA, XHELLIL, SHEMB, API, J, IO, TAVAN, MËK, SALON, BESNIK HASI, ALKATRAZ, S, SVEN, A, NOT, KADIU, SIDO, QENAN, GOMAR, TARIKATI, E.



## BEYONCE FITON NË MINUTË, AQ SA FITON NJË SHQIPTAR NË NJË MUAJ

Revista prestigjioze "Forbes" shpalli këtë fundvit edhe listën e artistëve më të pasur në glob, listë e cila kryesohej nga Beyonce me të ardhura 105 milionë dollarë dhe më pas pasohej nga Adele me 69 milionë dollarë. Të gjitha këto të ardhura janë pasqyruar pas llogaritjes së taksave dhe shpenzimeve të

tjera ekstra. Sërisht "Forbes", me një përlo-garitje të thjeshtë nga qershori i 2016-ës deri në qershorin e 2017-ës, harku kohor që mat pasurinë e të famshmëve, ka treguar edhe sa para ka fituar kryesuesja e listës në një minutë, transmeton syri.net. Në një hark kohor prej një minute, Beyonce ka fituar plot 202 dollarë (të patakruar) ndërkohë që paga mesatare vjetore në Shqipëri për këtë vit ka qenë afërsisht 209 euro neto.

## Gruaja lirohet pas 22 vitesh për krimin që s'e ka bërë

Një grua që ka qenë e burgosur për 22 vjet, për një vrasje që nuk e ka kryer, është liruar pas një kampanje nga disa të famshëm që ajo të kalonte në liri. Tyra Patterson, tash 42 vjeçe, është liruar në Ditën e Krishtlindjes nga qendra e paraburgimit në verilindje të Cleveland, shkruan Sun. Patterson ishte akuzuar në vitin 1994 për vrasje dhe grabitje të një 15 vjeçareje në Dayton të Ohio. Ajo ka qenë një nga pesë të akuzuar për vrasje e vajzës, grabitjen e motrës së saj si dhe tre vajzave të tjera. Patterson, aso kohe 19 vjeçe, nuk kishite shtir në viktimën. Por që bashkëpjesëmarrja në krim sipas ligjeve të Ohio është e njëjtë sikur të tërhiqet këmbë-



za. Të famshmit kryesorë që bënë kampanjën për lirim e saj, janë filmbërësi

Ken Burns, aktorja Alfre Woodard dhe aktori Matheë Weiner.

## Në stomakun e pacientes 152 objekte metalike, ndër ta edhe vida e gozhda

Pas operimit të një gruaje, mjekët rusë u befasant nga përmbajtja e stomakut të saj, e cila përmbante 152 objekte të ndryshme metalike. Gruaja 74-vjeçare ruse kishte ardhur në spital për shkak të problemeve krejtësisht të ndryshme, por kontrolli i hollësishëm zbuloi se stomaku i saj përmban vida, gozhda dhe objekte të tjera metalike. Mjekja Irina Golisheva, e cila kreu procedurën e operimit, konfirmoi se fyti i pacientes është në gjendje të rregullt, por zbuloi se në stomak pacientja kishte një sasi të madhe objekteve të ndryshme metalike. Pas një ekzaminimi të hollësishëm, ajo gjeti se këto ishin gozhda dhe vida. Ajo u përpoq duke përdorur një

endoskop për t'i nxjerrë jashtë, por ajo arriti të nxjerrë vetëm katër vida. Meqenëse ajo nuk donte ta ekspozonte gruan me rrezik të mëtejshëm, urdhëroi urgjentisht kirurgët për konsultime. Ndër objektet që i janë gjetur në stomak pati edhe tel armature të gjata deri 15 centimetra, madje edhe një zinxhir argjendi. Në fund, 152 objekte metalike u hoqën nga stomaku, të cilat tashmë kishin filluar të oksidoheshin. Askush nuk mund të thoshte se sa kohë ishin gjithë këto gjëra në stomakun e pacientes. Pacientja nuk mund të shpjegojë se si u gjetën gozhdat dhe vidat në stomak, pasi nuk mund të flasë për shkak se ka pësuar pjesërisht sulm në tru.



## Mollët dhe domatet t'i mbajnë mushkëritë të reja

Ngrënia e frutave të freskëta mban mushkëritë tuaja të reja. Kjo ka dalë pas një studimi të kryer në Bloomberg School, ku ish duhanpirësit me një dietë të lartë, e duke ngrënë molla dhe domate dhe prodhime tjera të freskëta, kanë më shumë shanse të rikthejnë funksionimin e plotë të organeve të frymëmarrjes sesa ata që nuk i hanë ato. "Ky studim nxjerr se dieta mund të riparojë dëmet në mushkëritë e njerëzve të cilët kanë lënë duhanin", ka thënë autorja e studimit, Vanessa Garcia-Larsen. "Ky studim sugjeron që dieta e pasur me fruta mund të zvogëlojë plakjen e mushkërive edhe nëse kurrë nuk keni pirë duhanin", ka thënë ajo. Mushkëritë arrijnë 'pjekurinë' mes moshës 20-25 vjeç, në pas moshës 35 vjeçare fillojnë të pësojnë rënie.

1170 - Thomas Becket, Kryepeshkopi i Canterbury, vritet brenda Katedrales nga ana e ithtarëve të Mbretit Henry II; Ai më pas shpallet i shenjtë dhe martir nga ana e Kishës Anglikane dhe asaj Katolike Romake.

1503 - Beteja e Kariljanos: Ushtria spanjolle mund ushtrinë franceze.

1541 - Isabella e Polonisë dhe Mbreti Ferdinand i Austrisë nënshkruajnë Traktatin e Gilait.

1845 - Teksasi shpallet si shteti i 28 i SHBA-ve.

1911 - Mongolia fiton pavarësinë nga Dinsatia Kuing.

1920 - Holanda dhe Venezuela përmirësojnë marrëdhëniet diplomatike.

1920 - Qeveria jugosllave nuk e njeh Partinë Komuniste.

1948 - Kanadaja njeh Izraelin.

1967 - Formohet Qeveria turko-qipriote në Qipro.

1989 - Vaclav Havel zgjidhet kryetar i Çekosllovakisë.

1997 - Hong Kongu fillon me prerjen të gjitha pulat për të parandaluar gripin e shpendëve.

Kanella është një erëz shumë e vjetër dhe e çmuar. Vlerat shëndetësore të saj janë befasuese. Ajo përmban shumë oksidantë të fuqishëm siç është polifenoli. Hulumtimi i zhvilluar në Shtetet e Bashkuara për pacientët që ishin në fazat e para të diabetit treguan se erëza në fjalë e përdorur për dymbëdhjetë javë ka ulur nivelet e sheqerit në gjak. Gjithashtu, ky produkt është i efektshëm edhe kundër mikrobeve dhe baktereve. Ajo forcon sistemin imunitar, shëron ftohjet dhe gripin. Kanella vepron edhe kundër problemeve kardiake, kundër hipertensionit, ka efekte pozitive në sistemin e frymëmarrjes dhe të tretjes. Kanella përmirëson kujtesën dhe përqendrimin.



### DJALI INTELIGJENT

Një djalë shumë "inteligjent" shkon për të kërkuar dorën e vajzës, tek shtëpia e të atit të saj.

- Kam ardhur t'ju kërkoj dorën e vajzës suaj?

- Cilën, të madhen apo të voglën?

- Më falni, por nuk e dija që vajza juaj paska një dorë të madhe dhe tjetrën më të vogël...



Mos shko aty ku të shpie shtegu, por shko atje ku nuk ka shteg dhe lër gjurmë. (Ralph Waldo Emerson)



KALENDARI HISTORIK 29 DHJETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS